

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	- Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për deklaratat financiare vjetore, deklaratat financiare të konsoliduara dhe raportet e lidhura me disa lloje sipërmarrjesh”, i ndryshuar, e konsoliduar. - Direktivën EU 2026/470 (of THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 24 February 2026 amending Directives 2006/43/EC, 2013/34/EU, (EU) 2022/2464 and (EU) 2024/1760 as regards certain corporate sustainability reporting requirements and certain corporate sustainability due diligence requirements).
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Programin e Qeverisë 2021-2025; Programi Kombëtar mbi Integrimin Evropian
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	02/04/2026 - 30/04/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	30/04/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 15/04/2026 Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MF – Nr. 2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)	Erisa Rodhani Erisa.Rodhani@financa.gov.al 0696429064
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
(Maksimumi 2 faqe)	

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Në praktikë, kuadri aktual ligjor ka krijuar një bazë të rëndësishme për raportimin financiar, por zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e raportimit të qëndrueshmërisë dhe transparencës së korporatave, kërkojnë përditësimin dhe përshtatjen e mëtejshme të tij. Pa një ndërhyrje të tillë, ekziston rreziku që kuadri ligjor kombëtar të mos jetë plotësisht i harmonizuar me standardet dhe kërkesat më të fundit evropiane, duke krijuar boshllëqe në raportimin e kompanive dhe në cilësinë e informacionit që u ofrohet investitorëve, institucioneve publike dhe publikut të gjerë.

Disa nga problematikat aktuale janë si vijon:

Problematikat kryesore lidhet me mungesën e një kuadri të plotë për raportimin e qëndrueshmërisë. Në nivel të Bashkimit Evropian, kërkohet gjithnjë e më shumë që njësitë ekonomike të raportojnë jo vetëm për performancën e tyre financiare, por edhe për ndikimin që aktiviteti i tyre ka në mjedis, në aspektet sociale dhe në mënyrën e qeverisjes së njësisë. Kuadri aktual ligjor në Shqipëri nuk përfshin në mënyrë të plotë këto kërkesa, duke e bërë të nevojshëm përditësimin e ligjit për të reflektuar zhvillimet e reja në raportimin e qëndrueshmërisë dhe për të krijuar një bazë të qartë për zbatimin e tyre në të ardhmen.

Raportimi i qëndrueshmërisë është i pjesshëm dhe jo në nivelin e kërkuar. Ligji aktual përfshin vetëm disa elementë jofinanciarë, por nuk parashikon raportimin e detajuar ESG, politikën e qëndrueshmërisë, kërkesat për zinxhirin e vlerës, verifikimin e raportit ESG. Kjo mospërputhje e pengon Shqipërinë të jetë plotësisht e harmonizuar me standardet europiane dhe krijon boshllëqe ligjore në raportim dhe transparencë.

Nuk përfshihen detyrimet për raportim publik të tatimit mbi të ardhurat. Ligji nr. 25/2018 nuk përfshin detyrimet për raportim publik të tatimit mbi të ardhurat nga grupet e mëdha shumëkombëshe. Kjo krijon boshllëqe në transparencën fiskale dhe ul besueshmërinë e sistemit tatimor shqiptar.

Paqartësi në përcaktimin e subjekteve që kanë detyrimin për raportim të qëndrueshmërisë. Aktualisht ligji në fuqi nuk përcakton qartë ndërmarrjet që duhet të raportojnë ESG, apo që përfshihen në raportimin e konsoliduar, si dhe kriteret për subjekte të vogla, të mesme dhe të mëdha sipas pragjeve të BE-së. Kjo krijon pasiguri juridike, interpretim të dyfishtë dhe zbatim të pabarabartë të ligjit.

Vështirësi në zbatimin praktik të konsolidimit të pasqyrave financiare Në praktikë janë evidentuar në disa raste vështirësi në konsolidimin e grupeve, përcaktimin e njësive të kontrolluara, raportimin e ecurisë së veprimtarisë në nivel grupi. Në këtë mënyrë nisma e propozuar sjell përcaktime të qarta, duke shmangur interpretimet e pasakta.

Terminologji sipas standardeve të BE-së. Ligji aktual përmban terma të papërafuar me standardet e BE-së, mungesë të ndarjes midis koncepteve financiare dhe jofinanciare dhe nuk adreson qartë detyrimet e ruajtjes së dokumenteve dhe cilësinë e shënimeve shpjeguese. Për shkak të paqartësive bizneset raportojnë në mënyrë të pabarabartë, si dhe autoritetet nuk kanë bazë të unifikuar verifikimi.

Sistemi aktual nuk garanton transparencë në përputhje me standardet europiane, pasi nuk parashikon publikimin e detyrueshëm të raporteve të qëndrueshmërisë, raporteve të konsoliduara, raportit të tatimit mbi të ardhurat, dokumenteve të tjera të detajuara të raportimit. Kjo ndikon në uljen e transparencës dhe mospërmbushjen e standardeve që të vendosur nga BE.

Ligji aktual nuk përcakton indikatorët e detyrueshëm ESG, formatet e raportimit, kërkesat e dhënies së sigurisë, lidhjen midis raportimit financiar dhe atij të qëndrueshmërisë. Kjo krijon pasaktësi, raportim të pakrahasueshëm dhe konfuzion te përdoruesit e informacionit.

Rritja e nevojës për mbrojtjen e ndërmarrjeve të vogla në raport me zinxhirët e furnizimit. Pa rregulla të qarta, bizneset e vogla mbingarkohen nga kërkesat për informacion të tepërt. Nisma parashikon statusin e “njësive të mbrojtura”, duke ruajtur proporcionalitetin.

Forcimi i klimës së investimeve. Në mungesë të raportimeve të standardizuara dhe të verifikuara, investitorët nuk kanë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar realisht rreziqet dhe performancën e ndërmarrjeve. Kjo ul konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe pengon investimet e huaja direkte.

Gjithashtu, është evidentuar nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare. Megjithëse Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në adoptimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, në praktikë mbeten ende sfida që lidhen me zbatimin e njëtrajtshëm të këtyre standardeve, me cilësinë e raportimit nga kompanitë dhe me disponueshmërinë e informacionit të besueshëm financiar për përdoruesit e tij. Për këtë arsye, rishikimi i ligjit synon të forcojë mekanizmat që garantojnë zbatimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të përmirësojë kuadrin rregullator që mbështet transparencën dhe besueshmërinë e raportimit financiar.

Ndërhyrja e qeverisë në këtë rast është e domosdoshme për arsyet kryesore. Së pari, për të siguruar harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit evropian. Së dyti, për të krijuar një kuadër ligjor të përditësuar dhe funksional që mbështet zhvillimin e tregut, përmirëson klimën e biznesit dhe rrit besimin e investitorëve vendas dhe të huaj. Së treti, për të garantuar transparencë më të madhe në aktivitetin e njësive ekonomike dhe për të përmirësuar cilësinë e informacionit financiar dhe jo-financiar që përdoret nga institucionet publike, investitorët dhe palët e tjera të interesuara.

Në këtë mënyrë, rishikimi i ligjit nr. 25/2018 synon jo vetëm harmonizimin me standardet evropiane, por edhe modernizimin e kuadrit të raportimit financiar në Shqipëri, duke

kontribuar në zhvillimin e një sistemi më transparent, më të besueshëm dhe më të përafruar me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Projektligji synon të arrijë këta objektiva:

1. Përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në kapitullin 6 të acquis-së ku pjesa kryesore i përket raportimit të qëndrueshmërisë, brenda vitit 2026;
2. Përcaktimi i qartë i njësive që janë të detyruara të kryejnë raportimin e qëndrueshmërisë;
3. Përmirësimi i dhe forcimi i rregullave për raportimin financiar të njësive me interes publik (NJEIP);
4. Sigurimi i qartësisë së të plotë të kërkesave ligjore për informacionin mbi fitimin dhe tatimet e paguara nga korporatat e mëdha shumëkombëshe të BE-së dhe ato jo-BE që kanë filiale që operojnë në BE, në përputhje me direktivën përkatëse, brenda vitit 2027, me qëllim rritjen e qartësisë rregullatore dhe harmonizimin e raportimit financiar.
5. Qartësimi dhe unifikimi i terminologjive përkatëse, brenda vitit 2027, me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së dispozitave dhe rritjen e qartësisë në interpretimin e tyre nga subjektet raportuese.
6. Rritja e cilësisë së raportimit financiar duke siguruar që të gjitha njësitë ekonomike t'i hartojnë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ose me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar; Standardizimi i përbërësve minimalë të pasqyrave financiare për çdo kategori njësie ekonomike (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha), me qëllim rritjen e uniformitetit, krahasueshmërisë dhe cilësisë së raportimit financiar, brenda vitit 2027.
7. Vendosja e sistemit të detyrueshëm të raportimit të qëndrueshmërisë për ndërmarrjet që tejkalojnë 1 000 punonjës dhe 450 milionë euro të ardhura neto, që nga periudha raportuese 2028;
8. Rritja e transparencës së raportimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, ku njësitë e mesme, të mëdha dhe ato me interes publik detyrohen të publikojnë pasqyrat financiare në faqen zyrtare të internetit brenda 7 muajve;
9. Rregullimi i mënyrës së raportimit financiar për degët dhe njësitë ekonomike të huaja që operojnë në Shqipëri, në rastet kur raporti i konsoliduar i shoqërisë mëmë nuk është i disponueshëm, me qëllim sigurimin e raportimit të plotë, të krahasueshëm dhe të zbatueshëm në praktikë;
10. Vendosja e detyrimit për raportim “Country by Country” të tatimit mbi të ardhurat për njësitë ekonomike shumëkombëshe që tejkalojnë pragun e 750 milionë eurove të ardhura në dy vite radhazi, me synim rritjen e transparencës fiskale dhe përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian, brenda vitit 2027.

11. Sigurimi i një sistemi të unifikuar, të digjitalizuar dhe të besueshëm kontabël, ku detyrohet ruajtja e dokumenteve kontabël për të paktën 5 vite;
12. Forcimi i integriteti i të dhënave përmes rregullave të qarta të regjistrimit kronologjik dhe sistematik;
13. Sigurimi që raportet e qëndrueshmërisë të hartohen plotësisht në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS), me synim rritjen e cilësisë, krahasueshmërisë dhe harmonizimit të raportimit jofinanciar me kërkesat e Bashkimit Evropian, brenda vitit 2027;
14. Vendosja e detyrimit për verifikim të kufizuar (limited assurance) të raporteve të qëndrueshmërisë nga audituesit ligjorë, brenda vitit 2027;

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo)- nënkupton moskryerjen e ndryshimeve rregullatore dhe jorregullatore, por vijimin me kuadrin ligjor aktual.

Ky nuk është opsioni i përshtatshëm për arsyet si vijon:

- **Shqipëria nuk do të mund të përmbushë përafrimin me acquis të BE-së**, duke qenë se Direktiva 2013/34/BE dhe ndryshimet e saj nuk janë të transpozuar plotësisht në ligjin aktual. Në këtë mënyrë mosmiratimi i kësaj nisme do të pengonte përmbushjen e detyrimeve të Integritetit Evropian.
- Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë nuk janë të parashikuara në kuadrin aktual. Ndërmarrjet shqiptare mbeten jashtë tregjeve europiane, të cilat pengohen të hyjnë në kontrata me zinxhirët europianë, si dhe rritet rreziku i mospërputhshmërisë me kërkesat e investitorëve ndërkombëtarë
- Ligji aktual nuk garanton procese të standardizuara, rregulla të qarta për ruajtjen e dokumenteve, si dhe kërkesa të avancuara të raportimit të konsoliduar.

Avantazhet

- Nuk krijon ngarkesë shtesë administrative, si në burime njerëzore apo materiale, si dhe nuk ka nevojë të krijohen sisteme të reja, apo portale të reja.
- Bizneset nuk duhet të adaptojnë standarde të reja, të përgatisin raporte shtesë, apo të trajnohen.

Opsioni 1 (jo rregullator) -nënkupton marrjen e masave jorregullatore si rritja e kontrolleve dhe kryerja e fushatave ndërgjegjësuese.

Ky option nuk mund të aplikohet për arsye se:

Problemet aktuale janë të natyrës ligjore. Harmonizimi me standardet e Bashkimit Evropian **nuk mund të arrihet vetëm nëpërmjet trajnimeve, fushatave apo kontrolleve**, por kërkohet një **bazë e re ligjore**.

Ligji ekzistues ka disa problematika si klasifikim i vjetruar i njësive ekonomike, mungesë e detyrimeve të reja të transparencës, mungesë rregullash për raportimin konsoliduar të qëndrueshmërisë. Këto **nuk mund të rregullohen me masa jorregullatore**.

Standardet e reja (ESRS, IFRS të përditësuara) nuk mund të bëhen detyruese pa ndryshim ligjor.

Për më tepër, mungesa e standardeve ligjore të raportimit të qëndrueshmërisë dhe transparencës tatimore krijon rrezik për investorët e huaj, për qasjen në tregun e BE-së, për vlerësimet ndërkombëtare të vendit.

Avantazhet

Zbatim i shpejtë dhe fleksibël, ku masat jorregullatore mund të zbatohen menjëherë pa procedura ligjore për miratimin e tyre.

Kosto më e ulët administrative, ku institucionet nuk kanë nevojë të krijojnë mekanizma të rinj ligjorë, sisteme raportimi apo struktura të reja.

Mund të rrisë ndërgjegjësimin, ku fushatat, trajnimet dhe komunikimet ndihmojnë bizneset të kuptojnë standardet ekzistuese.

Opsioni 2 (rregullator) i preferuar:– nënkupton ndryshimin e ligjit ekzistues, konkretisht ligjit nr.25/2018, *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*.

Ky është opsioni më i përshatshëm për t’u zbatuar, për arsye se nëpërmjet nismës së propozuar do të mundësohet do të arrihen objektivat e synuar, pasi dispozitat aktuale të ligjit do të ndryshohen në përshtatje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Opsioni 2 vlerësohet si opsioni më i përshtatshëm për t’u zbatuar, për arsye se nëpërmjet nismës së propozuar nuk do të kryhen ndryshime që prekin të gjithë apo pjesën më të madhe të dispozitave të ligjit në tërësi, por do të mundësohet kryerja e disa saktësimeve dhe shtesave në dispozitat aktuale të këtij ligji. Për pasojë duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk do të prekin gjithë ligjin në tërësi, opsioni 2 rezulton si opsion më i përshtatshëm.

Opsioni rregullator – ndryshimi i ligjit nr.25/2018 – është opsioni më i përshtatshëm pasi natyra e ndryshimeve të nevojshme është plotësisht **rregullatore** dhe këto ndryshime nuk mund të adresohen me mjete jorregullatore.

Ligji aktual nuk përmban konceptet e reja të raportimit të qëndrueshmërisë (ESG), standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS), detyrimet e reja të grupeve. Këto kërkesa burojnë drejtpërdrejt nga direktivat e Bashkimit Europian, të cilat kërkojnë përafrim të plotë ligjor, duke bërë të domosdoshëm ndërhyrjen në ligjin bazë.

Avantazhet

Përafrim i plotë me acquis të BE-së. Nisma e propozuar për ndryshimin e ligjit është e domosdoshëm për të siguruar përafrimin e plotë me acquis të BE-së, në veçanti me kërkesat e zgjeruara të Direktivës CSRD dhe me standardet ESRS të hartuara nga EFRAG, të cilat prekin drejtpërdrejt mënyrën e raportimit jofinanciar dhe strukturën e informacionit të detyrueshëm.

Modernizim i kornizës kombëtare të kontabilitetit. Ligji ekzistues i vitit 2018 nuk përfshin konceptet bashkëkohore të qeverisjes korporative, raportimit të qëndrueshmërisë, zinxhirit të vlerës, publikimit të detajuar, standardeve vullnetare dhe as mekanizma të rinj të konsolidimit. Vendosja e dispozitave të reja mbi raportimin ESG, verifikimin e raporteve të qëndrueshmërisë, raportimin e tatimit mbi të ardhurat dhe rregullat e detajuara të konsolidimit përbën një modernizim struktural, jo thjesht procedural.

Rritje e transparencës, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së informacionit. Raportimi i qëndrueshmërisë, informacioni ESG, raportet e detyrueshme të zinxhirit të vlerës dhe raportimi i publik i tatimit mbi të ardhurat krijojnë një nivel të ri transparence për bizneset, duke bërë të mundur që investitorët, konsumatorët dhe institucionet të kenë qasje më të plotë të informacioni për performancën dhe përgjegjshmërinë e ndërmarrjeve. Kjo përmirëson qartësinë e informacionit financiar dhe jofinanciar dhe rrjedhimisht ul rrezikun e keqinformimit.

Përmirësim i klimës së biznesit dhe tërheqje e investimeve. Transparenca e shtuar, përputhshmëria me standardet europiane dhe rritja e cilësisë së raportimit e bëjnë Shqipërinë një destinacion më të sigurt për investitorët e huaj dhe vendas. Harmonizimi me standardet ESRS dhe me kërkesat e BE-së i jep investitorëve siguri se raportet e subjekteve shqiptare janë të krahasueshme me ato të ndërmarrjeve europiane.

Mbrojtja e bizneseve të vogla dhe të mesme nga ngarkesa të panevojshme. Fakti se subjekti raportues nuk mund të kërkojë të dhëna shtesë që tejkalojnë këto standarde, ul ndjeshëm barrën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo qasje e balancuar ruan konkurrueshmërinë e tyre, shmang kosto të panevojshme dhe siguron që barra e raportimit të fokusohet kryesisht te ndërmarrjet e mëdha dhe grupet me ndikim të rëndësishëm ekonomik.

Periudha të qarta tranzitore, ku detyrimet për raportimin e qëndrueshmërisë dhe për raportimin e tatimit mbi të ardhurat bëhen të detyrueshme duke filluar nga periudhat raportuese 2028. Kjo qasje u jep ndërmarrjeve kohë të mjaftueshme për të ngritur kapacitetet

e tyre të brendshme, për t'u pajisur me sistemet e duhura të teknologjisë së informacionit, për të trajnuar stafin dhe për të vendosur praktikatat e mbledhjes së të dhënave.

Ndërhyrjet e propozuara, **nuk tejkalojnë pragun 50% të ndryshimeve në ligjin ekzistues**. Sipas parimeve të teknikës legjislative, kur ndryshimet nuk prekin më shumë se gjysmën e dispozitave të ligjit bazë, **ndërhyrja duhet të bëhet përmes ndryshimeve dhe shtesave në ligjin ekzistues**, jo përmes hartimit të një ligji krejtësisht të ri. Kjo siguron koherencë, qartësi dhe vazhdimësi në legjislacion, duke shmangur nevojën për të ristrukturuar të gjithë aktin dhe për të ndryshuar në mënyrë të panevojshme strukturën e tij themelore.

Pjesa më e madhe e dispozitave themelore, parimeve dhe mekanizmave ekzistues ruhet, ndërsa ndryshimet fokusohen në shtesa dhe riformulime që lidhen drejtpërdrejt me përafrimin me acquis të BE-së. Dispozitat e reja janë të integruar si nene shtesë, pa cenuar strukturën themelore të ligjit. Kjo tregon se ndërhyrjet **nuk justifikojnë për hartimin e një ligji krejtësisht të ri**, por përkundrazi konfirmojnë se opsioni i duhur është ai rregullator: ndryshimi i ligjit ekzistues.

Për më tepër, ruajtja e ligjit bazë dhe ndërhyrjet përmes shtesave e ndryshimeve siguron **vazhdimësi juridike**, shmang boshllëqet, shmang konfuzionin të subjektet e zbatimit dhe i jep kohë subjekteve të përshtaten me detyrimet e reja.

Disavantazhet

Biznest veçanërisht ato të mëdha dhe grupet, duhet të sigurojnë, përgatitjen e raporteve të qëndrueshmërisë, përmirësimin e proceseve të kontabilitetit dhe pagesën e verifikimit të detyrueshëm nga audituesit. Këto kosto mund të ndikojnë në efikasitetin financiar të subjekteve në fazat e para të zbatimit.

Subjektet duhet të kuptojnë dhe zbatojnë standarde të detajuara të ESRS, procedura verifikimi dhe kërkesa të reja për publikim. Kjo rrit mund të krijojë vështirësi interpretimi.

Nevoja për trajnim si për profesionistët e kontabilitetit, audituesit, ashtu edhe subjektet që përfshihen në fushën e detyrimeve.

Opsioni 3 (rregullator): – Miratimi i një ligji të ri në fushën e raportimit financiar.

Opsioni që parashikon miratimin e një ligji të ri nuk konsiderohet i përshtatshëm, sepse ndërhyrjet që synohen të ndërmerren me këtë reformë nuk prekin thelbin, strukturën dhe parimet bazë të ligjit nr.25/2018. Ndryshimet e propozuara kanë natyrë harmonizuese dhe përshtatëse, të cilat synojnë integrimin e kërkesave të reja të BE-së pa ndryshuar strukturën ligjore ekzistuese.

Duke qenë se ndryshimet nuk tejkalojnë rreth 50% të dispozitave të ligjit, ndërhyrja nuk mund të realizohet me hartimin e një ligji të ri. Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri do të

ishite një ndërhyrje disproporcionale, e panevojshme nga pikëpamja teknike dhe më e kushtueshme në burime njerëzore, materiale dhe kohore.

Për më tepër, hartimi i një ligji të ri do të kërkonte ristrukturimin e plotë të të gjithë kuadrit ekzistues, kjo do të sillte një barrë shtesë të konsiderueshme për administratën publike dhe për subjektet ekonomike, të cilat do të duhej të përshtateshin jo vetëm me kërkesat e reja të BE-së, por edhe me një arkitekturë të re ligjore, ndryshe nga ajo aktuale.

Avantazhet

Krijon një kornizë të re ligjore, plotësisht të harmonizuar me standardet e BE-së.

Fleksibilitet për të rishikuar strukturën ligjore. Nisma për hartimin e një ligji të ri do të mundësonte rindërtimin e kapitujve, ndarjen e përgjegjësisë dhe një logjikë të re sistematike.

Disavantazhet

Ndryshimet aktuale nuk e justifikojnë hartimin e një ligji të ri duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të ligjit aktual dhe nuk ndryshojnë strukturën bazë të ligjit ekzistues. Kjo e bën hartimin e një ligji të ri të pajustificuar nga ana e teknikës legjislative.

Kosto shumë më të lartë në burime njerëzore, materiale dhe financiare duke qenë se do të rishikohej ligji në tërësi, kjo do të sillte pengesa të shumëta gjatë përshtatjes së tij/ hartimit, si dhe do të kërkonte investim të konsiderueshëm si në burime njerëzore, materiale dhe financiare.

Kosto e lartë për subjektet ekonomike. Bizneset do të duhej, të trajnojnë stafin, të ndryshojnë sistemet e brendshme, të përditësojnë politikat, gjë që krijon barrë të panevojshme .

Nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes ligjore. Duke qenë se objektivat mund të arrihet përmes ndryshimeve në ligjin aktual, hartimi i një ligji të ri është i pajustificueshem.

Mund të krijojë vonesa në procesin e përafrimit ligjor me BE-në. Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri kërkon më tepër kohë dhe kjo do të ndikonte duke rrezikuar afatet për transpozimin e kërkesave të CSRD dhe ESRS.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

- **Rritje e transparencës, besueshmërisë dhe efikasitetit të tregut.** Nisma e propozuar ndikon në rritjen e transparencës, besueshmërisë dhe efikasitetin e tregut. Kërkesat e reja për raportim financiar, raportim të qëndrueshmërisë, raportim

tatimor, verifikim dhe publikim krijojnë një mjedis më të sigurt për investime. Rritja e cilësisë dhe saktësisë së informacionit financiar dhe jofinanciar i ndihmon investitorët të vlerësojnë më mirë rreziqet, qëndrueshmërinë afatgjatë, modelet e biznesit dhe performancën e kompanive.

- **Rritja e konkurrueshmërisë dhe zgjerimi i mundësive të bashkëpunimit të kompanive shqiptare me kompani ndërkombëtare,** sidomos në sektorët ku investitorët apo klientët kërkojnë konformitet me standardet ESG (si industria e tekstileve, fasoneria, energjia, ndërtimi, industria përpunuese). Kjo rrit konkurrueshmërinë rajonale dhe nxit rritjen ekonomike. Mbrojtja që ligji u jep ndërmarrjeve të vogla në zinxhirin e vlerës nga kërkesat e tepruara të të dhënave ndihmon që zinxhirët të funksionojnë pa u ngarkuar segmentet më të ndjeshme të ekonomisë.
- **Reduktim i praktikave të evazionit** Vendosja e raportimit publik të tatimit mbi të ardhurat (public CbCR) ka ndikim pozitiv në uljen e shmangies fiskale, në rritjen e transparencës mbi aktivitetet ndërkufitare dhe në identifikimin më të saktë të zhvendosjes artificiale të fitimeve. Kjo rrit efikasitetin e administrimit tatimor, pasi bizneset që operojnë me strukturime të ndërlikuara ndërkombëtare do të jenë të detyruara të raportojnë më qartë dhe publikisht të dhënat e tyre tatimore.
- **Tërheqja e investimeve të huaja.** Përafrimi me kërkesat e BE-së (CSRD, ESRS, public CbCR) e vendos Shqipërinë në të njëjtin standard me tregjet e BE-së, duke e bërë vendin më tërheqës për investitorët e huaj.

Ndikimet në sektorin publik

- **Përmirësimi i monitorimit të tregut dhe politikbërjes.** Nisma e propozuar përmirëson kapacitetet e monitorimit dhe analizës së institucioneve publike. Duke qenë se subjektet ekonomike do të publikojnë raportet financiare, raportet e qëndrueshmërisë dhe raportet e tatimit mbi të ardhurat institucionet përgjegjëse do të kenë akses në një volum shumë më të madh informacioni të verifikuar dhe të standardizuar. Kjo mundëson analiza më të sakta të rreziqeve makroekonomike, tendencave të zhvillimit ekonomik, pajtueshmërisë fiskale dhe progresit në drejtim të objektivave të qëndrueshmërisë së vendit.
- **Rritja e transparencës së institucioneve.** Nisma e propozuar kontribuon në përmirësimin e llogaridhënies publike. Raportet, të cilat publikohen janë të aksesueshme nga publiku dhe kjo rrit përgjegjësinë mbi institucionet dhe ndërmarrjet publike për të qenë më transparente, si dhe ndihmon qeverinë të përmbushë detyrimet ndërkombëtare të transparencës fiskale dhe të raportimit të qëndrueshmërisë.
- **Zbatimi efikas i detyrimeve ndërkombëtare.** Nisma e propozuar siguron harmonizim të plotë me kërkesat e BE-së, duke e afruar Shqipërinë me standardet e anëtarësimit dhe duke rritur reputacionin institucional në arenën ndërkombëtare.

- **Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse. Nisma ndikon gjithashtu edhe në forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse,** duke i dhënë **Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit** kompetenca të në publikimin, përkthimin, monitorimin dhe shpalljen e standardeve të raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS). Kjo rrit rolin e tij si një institucion teknik kombëtar tërësisht i harmonizuar me praktikatat e BE-së dhe e bën atë një aktor kyç në politikëbërjen ekonomike dhe rregullatore të vendit.

Ndikimet në sektorin privat

- **Rritje e menaxhimit të brendshëm për ndërmarrjet në sektorin privat.** Nisma e propozuar krijon vlerë të shtuar për ndërmarrjet e sektorit privat, duke i orientuar ato drejt standardeve moderne të raportimit dhe menaxhimit të brendshëm. Kërkesat e raportimit të qëndrueshmërisë (ESG) i ndihmojnë kompanitë të identifikojnë rreziqet dhe mundësitë që lidhen me faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes, duke i orientuar drejt planeve më të mira strategjike dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë.
- **Përmirësim i reputacionit të ndërmarrjeve.** Për ndërmarrjet e mëdha dhe grupet, nisma ndikon në rritjen e reputacionit ndërkombëtar, pasi raportet e tyre do të jenë të verifikuara, të standardizuara dhe të krahasueshme me ato të kompanive të BE-së. Kjo u mundëson të përfshihen në projekte globale dhe të plotësojnë kriteret ESG të institucioneve financiare ndërkombëtare.
- **Mosngarkimi i ndërmarrjeve të vogla me kërkesa të tepërta.** Nisma e propozuar kufizon qartë detyrimet e bizneseve të vogla për të mos u ngarkuar me kërkesa të tepërta të të dhënave. Kjo shmang barrën administrative dhe financiare të panevojshme për bizneset e vogla, duke garantuar proporcionalitet dhe ruajtur konkurrueshmërinë e tyre brenda zinxhirit të vlerës.
- **Përmirëson cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe efikasitetin operacional të kompanive,** duke qenë se kërkesat për ruajtjen e dokumenteve kontabël, për cilësinë e informacionit financiar dhe për raportet e konsoliduara i nxisin ndërmarrjet të vendosin sisteme moderne të kontabilitetit, qarkullimit të informacionit, mbledhjes së të dhënave dhe menaxhimit të rrezikut.

Ndikimet monetare të kësaj nisme pritet të jenë të kufizuara dhe kryesisht të lidhura me:

- kostot e trajnimit dhe zhvillimit profesional për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit;
- përditësimin e proceseve të raportimit financiar nga ana e bizneseve;
- përditësimin e udhëzimeve dhe akteve zbatuese nga institucionet përkatëse.

Megjithatë, këto kosto konsiderohen të moderuara dhe të përballueshme, duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk prekin në mënyrë thelbësore gjithë strukturën e ligjit ekzistues.

Përfitimet kryesore jo-monetare lidhen me:

- rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit financiar;
- përmirësimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare;

- forcimin e besimit të investitorëve dhe institucioneve financiare;
- përmirësimin e klimës së biznesit dhe të qeverisjes së korporatave;
- harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian.

Në tërësi, analiza e ndikimeve tregon se përfitimet afatgjata të kësaj nisme tejkalojnë kostot e mundshme të zbatimit, duke kontribuar në modernizimin e sistemit të raportimit financiar dhe në forcimin e transparencës dhe integritetit të tregut.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është Opsioni 2- Kryerja e ndryshimeve në ligjin aktual

Opsioni rregullator – ndryshimi i ligjit nr.25/2018 – është opsioni më i përshtatshëm pasi natyra e ndryshimeve të nevojshme është plotësisht **rregullatore** dhe këto ndryshime nuk mund të adresohen me mjete jorregullatore.

Ky është opsioni i përshtatshëm për arsye se nëpërmjet këtij opsioni sigurohet:

- **Përafrim i plotë me acquis të BE-së.** Nisma e propozuar për ndryshimin e ligjit është e domosdoshëm për të siguruar përafrimin e plotë me acquis të BE-së, në veçanti me kërkesat e zgjeruara të Direktivës CSRD dhe me standardet ESRS të hartuara nga EFRAG, të cilat prekin drejtpërdrejt mënyrën e raportimit jofinanciar dhe strukturën e informacionit të detyrueshëm.
- **Modernizim i kornizës kombëtare të kontabilitetit.** Ligji ekzistues i vitit 2018 nuk përfshin konceptet bashkëkohore të qeverisjes korporative, raportimit të qëndrueshmërisë, zinxhirit të vlerës, publikimit të detajuar, standardeve vullnetare dhe mekanizmave të rinj të konsolidimit. Vendosja e dispozitave të reja mbi raportimin ESG, verifikimin e raporteve të qëndrueshmërisë, raportimin e tatimit mbi të ardhurat dhe rregullat e detajuara të konsolidimit përbën një modernizim struktural, jo thjesht procedural.
- **Rritje e transparencës, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së informacionit.** Raportimi i qëndrueshmërisë, informacioni ESG, raportet e detyrueshme të zinxhirit të vlerës dhe raportimi i publik i tatimit mbi të ardhurat krijojnë një nivel të ri transparence për bizneset, duke bërë të mundur që investitorët, konsumatorët dhe institucionet të kenë qasje më të plotë te informacioni për performancën dhe përgjegjshmërinë e ndërmarrjeve. Kjo përmirëson qartësinë e informacionit financiar dhe jofinanciar dhe rrjedhimisht ul rrezikun e keqinformimit.
- **Përmirësim i klimës së biznesit dhe tërheqje e investimeve.** Transparenca e shtuar, përputhshmëria me standardet europiane dhe rritja e cilësisë së raportimit e bëjnë Shqipërinë një destinacion më të sigurt për investitorët e huaj dhe vendas. Harmonizimi me standardet ESRS dhe me kërkesat e BE-së i jep investitorëve siguri

se raportet e subjekteve shqiptare janë të krahasueshme me ato të ndërmarrjeve europiane.

- **Mbrojtja e bizneseve të vogla dhe të mesme nga ngarkesa të panevojshme.** Fakti se subjekti raportues nuk mund të kërkojë të dhëna shtesë që tejkalojnë këto standarde, ul ndjeshëm barrën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo qasje e balancuar ruan konkurrueshmërinë e tyre, shmang kosto të panevojshme.
- **Periudha të qarta tranzitore,** ku detyrimet për raportimin e qëndrueshmërisë dhe për raportimin e tatimit mbi të ardhurat bëhen të detyrueshme duke filluar nga periudhat raportuese 2028. Kjo qasje u jep ndërmarrjeve kohë të mjaftueshme për të ngritur kapacitetet e tyre të brendshme, për t'u pajisur me sistemet e duhura të teknologjisë së informacionit, për të trajnuar stafin dhe për të vendosur praktikatat e mbledhjes së të dhënave.
- Ndërhyrjet e propozuara, **nuk tejkalojnë pragun 50% të ndryshimeve në ligjin ekzistues.** Sipas parimeve të teknikës legjislative, kur ndryshimet nuk prekin më shumë se gjysmën e dispozitave të ligjit bazë, **ndërhyrja duhet të bëhet përmes ndryshimeve dhe shtesave në ligjin ekzistues,** jo përmes hartimit të një ligji krejtësisht të ri. Kjo siguron koherencë, qartësi dhe vazhdimësi në legjislacion, duke shmangur nevojën për të ristrukturuar të gjithë aktin dhe për të ndryshuar në mënyrë të panevojshme strukturën e tij themelore.
- Pjesa më e madhe e dispozitave themelore, parimeve dhe mekanizmave ekzistues ruhet, ndërsa ndryshimet fokusohen në shtesa dhe riformulime që lidhen drejtpërdrejt me përafrimin me acquis të BE-së. Dispozitat e reja janë të integruar si nene shtesë, pa cenuar strukturën themelore të ligjit. Kjo tregon se ndërhyrjet **nuk justifikojnë hartimin e një ligji të ri,** por përkundrazi konfirmojnë se opsioni i duhur është ai rregullator: ndryshimi i ligjit ekzistues.

Për më tepër, ruajtja e ligjit bazë dhe ndërhyrjet përmes shtesave e ndryshimeve siguron **vazhdimësi juridike,** shmang boshllëqet, shmang konfuzionin te subjektet e zbatimit dhe i jep kohë subjekteve të përshtaten me detyrimet e reja.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

Projektligji nuk ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji është hartuar dhe konsultuar ngushtësisht me konsulentët ndërkombëtarë të angazhuar nga Banka Botërore, në kuadër të mbështetjes teknike për reformimin e kuadrit ligjor në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në Shqipëri.

Gjatë gjithë procesit të hartimit, është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm me ekspertët e Bankës Botërore, me fokus të veçantë në përafrimin e dispozitave të projektligjit me acquis të Bashkimit Evropian dhe në veçanti me kërkesat e direktivave përkatëse të BE-së në fushën e kontabilitetit, raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë.

Në këtë kuadër, drafti i projektligjit i është nënshtruar një procesi të detajuar shqyrtimi teknik dhe ligjor nga konsulentët e Bankës Botërore, të cilët kanë paraqitur komente dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së tij, forcimin e koherencës ligjore, harmonizimin me standardet evropiane dhe zbatueshmërinë praktike të dispozitave të propozuara.

Të gjitha komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga ekspertët janë analizuar me kujdes nga grupi i punës dhe, në masën që janë vlerësuar të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat e reformës, janë reflektuar në versionin e rishikuar të projektligjit.

Gjithashtu projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve për Konsultimin Publik në datë 02.04.2026 deri në 30.04.2026. Aktualisht nuk ka patur komente, por ka patur një numër të lartë shikimesh rreth 706 shikime.

Projektligji është dërguar për mendim pranë Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH), Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM), Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP), Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Ministrinë të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI).

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen të gjithë profesionistët e fushës si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen edhe të gjitha njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të këtij ligji, janë të detyruara të kryejnë raportimin financiar si dhe raportimin e qëndrueshmërisë.

Për monitorimin ngarkohet Ministria e Financave, si institucioni kompetent për përmirësimin e kuadrit rregullator të fushës, nëpërmjet raportimeve që dërgojnë çdo vit institucionet mbikëqyrëse si KKK dhe BMP pranë MF.

Për më tepër, institucionet shtetërore do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kërkesave të reja ligjore, duke identifikuar problematikat që mund të lindin gjatë procesit të implementimit dhe duke propozuar masa për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator. Ky proces do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të politikave publike dhe në forcimin e rolit mbikëqyrës të institucioneve përgjegjëse.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- ***Jepni kontekstin e politikës***

Kuadri ligjor i kontabilitetit dhe raportimit financiar në Shqipëri ka kaluar disa faza zhvillimi, të cilat lidhen ngushtë me transformimet ekonomike të vendit, kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut dhe procesin e harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Pas ndryshimeve politike dhe ekonomike të fillimit të viteve '90, Shqipëria u përball me nevojën për të ndërtuar një sistem të ri kontabiliteti që t'i përgjigjej ekonomisë së tregut. Në këtë periudhë u krijuan bazat e para të një kuadri ligjor për kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësive ekonomike, duke u larguar nga sistemi i kontabilitetit të centralizuar të periudhës së mëparshme.

Së pari ka hyrë në fuqi ligji nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për Kontabilitetin”.

Ky ishte ligji i parë për kontabilitetin në Shqipëri pas tranzicionit. Ai vendosi rregullat bazë për mbajtjen e kontabilitetit nga njësitet ekonomike dhe për hartimin e pasqyrave financiare. Megjithatë, për shkak të zhvillimeve të shpejta të ekonomisë dhe nevojës për harmonizim me praktikatat ndërkombëtare, ky ligj kishte kufizime në drejtim të standardeve të raportimit financiar dhe mekanizmave të mbikëqyrjes.

Në vijim është miratuar ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

Në kuadër të reformave ekonomike dhe të procesit të afrimit me Bashkimin Evropian, Shqipëria miratoi një ligj të ri për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare në vitin 2004. Ky ligj përfaqësoi një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit të raportimit financiar, pasi:

- përcaktoi qartë detyrimet e njësive ekonomike për mbajtjen e kontabilitetit dhe për hartimin e pasqyrave financiare;
- vendosi bazat për aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- krijoi institucionin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) si organ përgjegjës për hartimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;
- përcaktoi klasifikimin e njësive ekonomike sipas madhësisë dhe kërkesat për raportim financiar për secilën kategori.

Ky ligj kontribuoi në rritjen e transparencës së raportimit financiar dhe në përmirësimin e praktikave kontabël në vend.

Në fund, është miratuar Ligji nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” (aktualisht në fuqi), në zbatim të këtij ligji është miratuar akti nënligjor VKM nr. 17, datë 16.01.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, ky është akti kryesor nënligjor që zbaton nenin 26 të ligjit dhe përcakton strukturën, përbërjen, procedurat e funksionimit të KKK, i cili zëvendëson ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Në vijim të zhvillimeve të reja në nivel evropian dhe të nevojës për harmonizim të mëtijshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në vitin 2018 u miratua ligji nr. 25/2018, i cili zëvendësoi ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Ky ligj u hartua kryesisht për të reflektuar kërkesat e Direktivës 2013/34/BE për pasqyrat financiare dhe për të modernizuar më tej kuadrin ligjor të raportimit financiar në Shqipëri.

Ligji nr. 25/2018 solli disa ndryshime të rëndësishme, ndër të cilat:

- përcaktimin më të qartë të kategorive të njësive ekonomike (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha) në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian;
- thjeshtimin e kërkesave të raportimit për njësitë ekonomike mikro dhe të vogla, në përputhje me parimin e proporcionalitetit;
- përmirësimin e strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare;
- forcimin e rolit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- rritjen e transparencës dhe krahasueshmërisë së informacionit financiar të njësive ekonomike.

Ky ligj përbën aktualisht bazën kryesore ligjore për sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar në Shqipëri dhe është një instrument i rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë së informacionit financiar, për përmirësimin e klimës së biznesit dhe për mbështetjen e procesit të integritetit evropian.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Zhvillimet e fundit në fushën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë në nivel ndërkombëtar dhe veçanërisht në Bashkimin Evropian kanë sjellë nevojën për përditësimin dhe përshtatjen e mëtijshme të kuadrit ligjor shqiptar në këtë fushë. Ligji nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” ka përbërë një bazë të rëndësishme për rregullimin e sistemit të raportimit financiar në vend dhe për përafrimin e tij me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, zhvillimet e reja në acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë, transparencën fiskale dhe përmirësimin e standardeve të raportimit financiar, kanë evidentuar mospërputhje dhe boshllëqe në kuadrin ligjor ekzistues shqiptar. Këto ndryshime kanë krijuar një problematikë konkrete, pasi dispozitat aktuale të ligjit nuk reflektojnë plotësisht kërkesat e reja evropiane, duke kufizuar nivelin e transparencës, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së raportimit financiar dhe atij të qëndrueshmërisë. Si rrjedhojë, mungesa e përafrimit të plotë me këto zhvillime rrezikon të pengojë integritetin e mëtijshëm të Shqipërisë në tregjet evropiane dhe të ndikojë negativisht në klimën e investimeve.

Një nga problematikat kryesore lidhet me faktin se kuadri aktual ligjor nuk reflekton plotësisht zhvillimet më të fundit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Në veçanti, direktivat më të fundit të Bashkimit Evropian, si Direktiva për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD). Këto direktiva kërkojnë që ndërmarrjet të raportojnë jo vetëm mbi informacionin financiar, por edhe mbi ndikimet e tyre mjedisore, sociale dhe të qeverisjes. Kuadri aktual ligjor në Shqipëri përfshin vetëm në mënyrë të pjesshme elementë të raportimit jofinanciar, çka krijon nevojën për përmirësimin dhe zgjerimin e dispozitave përkatëse për të siguruar një raportim më të plotë dhe më transparent.

Kjo situatë krijon një sërë problematikash konkrete në praktikë. Së pari, mungesa e përfshirjes së plotë të kërkesave për raportimin e qëndrueshmërisë sjell një nivel të ulët transparence mbi menaxhimin e ndërmarrjeve/shoqerive, duke e bërë më të vështirë vlerësimin e tyre nga investitorët dhe palët e interesuara.

Së dyti, krijohet mungesë krahasueshmërie me ndërmarrjet në vendet e Bashkimit Evropian, të cilat zbatojnë kërkesa më të avancuara sipas Direktivës për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD), duke vendosur bizneset shqiptare në një disavantazh konkurrues.

Gjithashtu, kjo situatë rrit pasigurinë rregullatore për subjektet raportuese, të cilat mund të përballen me kërkesa të paqarta ose të paplota, si dhe me kosto shtesë në të ardhmen për përshtatje të shpejtë me standardet e reja.

Në tërësi, kjo mungesë përafrimi kufizon besueshmërinë e raportimit, pengon tërheqjen e investimeve të huaja dhe ngadalëson procesin e integritetit evropian të vendit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i problemit lidhet me nevojën për përcaktimin më të qartë të subjekteve që duhet të përgatisin raportime të qëndrueshmërisë dhe të përmbushin kërkesat e reja të raportimit. Aktualisht, kriteret dhe detyrimet për disa kategori njësish ekonomike nuk janë të përcaktuara në mënyrë të mjaftueshme, gjë që mund të krijojë paqartësi në zbatimin e ligjit dhe në nivelin e përgjegjësisë së subjekteve raportuese.

Gjithashtu, janë evidentuar problematika që lidhen me zbatimin praktik të disa dispozitave të ligjit ekzistues, përfshirë çështje që kanë të bëjnë me qartësinë e terminologjisë, konsolidimin e pasqyrave financiare dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së disa kërkesave ligjore nga ana e njësive ekonomike. Këto problematika kanë treguar nevojën për saktësimin dhe përditësimin e disa dispozitave të ligjit, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të raportimit financiar në praktikë.

Në të njëjtën kohë, rritja e kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie në aktivitetin ekonomik, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ka theksuar rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare. Kuadri aktual i raportimit financiar nuk garanton në nivel të mjaftueshëm cilësinë, krahasueshmërinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Si pasojë, dobësohet besimi i investitorëve, kufizohet zhvillimi i tregjeve financiare dhe ndikohet negativisht klima e biznesit në vend. Një sistem raportimi financiar i besueshëm dhe i harmonizuar me standardet ndërkombëtare është një element thelbësor për forcimin e besimit të investitorëve, për zhvillimin e tregjeve financiare dhe për përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

Në këtë kontekst, problemi në shqyrtim lidhet me nevojën për përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të kontabilitetit dhe raportimit financiar, në mënyrë që ai të reflektojë zhvillimet më të fundit të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të adresojë problematikat e hasura në zbatimin e ligjit aktual dhe të krijojë një sistem raportimi financiar më transparent, më të besueshëm dhe më të harmonizuar me praktikën ndërkombëtare.

Në mungesë të këtyre ndryshimeve, ekziston rreziku që kuadri aktual ligjor të mos jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të mos garantojë nivelin e kërkuar të transparencës dhe cilësisë së raportimit financiar, çka mund të ndikojë negativisht në procesin e integritetit evropian, në besueshmërinë e informacionit financiar dhe në klimën e investimeve në vend.

Kjo situatë shkakton paqartësi në interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga njësitë ekonomike, çka çon në raportim jo të njëtrajtshëm dhe jo plotësisht të saktë. Si pasojë, ulet cilësia dhe besueshmëria e pasqyrave financiare, rritet rreziku për gabime dhe mosrespektim të kërkesave ligjore, si dhe krijohen vështirësi në mbikëqyrje dhe krahasueshmëri të të dhënave financiare.

Disa nga problematikat kryesore janë si vijon:

Raportimi i qëndrueshmërisë është i pjesshëm dhe jo në nivelin e kërkuar. Ligji aktual përfshin vetëm disa elementë jofinanciarë, por nuk parashikon raportimin e detajuar ESG, politikën e qëndrueshmërisë, kërkesat për zinxhirin e vlerës, verifikimin e raportit ESG. Kjo mospërputhje e pengon Shqipërinë të jetë plotësisht e harmonizuar me standardet europiane dhe krijon boshllëqe ligjore në raportim dhe transparencë.

Nuk përfshihen detyrimet për raportim publik të tatimit mbi të ardhurat. Ligji nr. 25/2018 nuk përfshin detyrimet për raportim publik të tatimit mbi të ardhurat nga grupet e mëdha shumëkombëshe. Kjo krijon boshllëqe në transparencën fiskale dhe ul besueshmërinë e sistemit tatimor shqiptar.

Paqartësi në përcaktimin e subjekteve që kanë detyrimin për raportim të qëndrueshmërisë. Aktualisht ligji në fuqi nuk përcakton qartë ndërmarrjet që duhet të raportojnë ESG, apo që përfshihen në raportimin e konsoliduar, si dhe kriteret për subjekte të vogla, të mesme dhe të mëdha sipas pragjeve të BE-së. Kjo krijon pasiguri juridike, interpretim të dyfishtë dhe zbatim të pabarabartë të ligjit.

Vështirësi në zbatimin praktik të konsolidimit të pasqyrave financiare. Në praktikë janë evidentuar në disa raste vështirësi në konsolidimin e grupeve, përcaktimin e njësive të kontrolluara, raportimin e ecurisë së veprimtarisë në nivel grupi. Në këtë mënyrë nisma e propozuar sjell përcaktime të qarta, duke shmangur interpretimet e pasakta.

Terminologji sipas standardeve të BE-së. Ligji aktual përmban terma të papërafruar me standardet e BE-së, mungesë të ndarjes midis koncepteve financiare dhe jofinanciare dhe nuk adreson qartë detyrimet e ruajtjes së dokumenteve dhe cilësinë e shënimeve shpjeguese. Për shkak të paqartësive bizneset raportojnë në mënyrë të pabarabartë, si dhe autoritetet nuk kanë bazë të unifikuar verifikimi.

Sistemi aktual nuk garanton transparencë në përputhje me standardet europiane, pasi nuk parashikon publikimin e detyrueshëm të raporteve të qëndrueshmërisë, raporteve të konsoliduara, raportit të tatimit mbi të ardhurat, dokumenteve të tjera të detajuara të raportimit. Kjo ndikon në uljen e transparencës dhe mospërmbushjen e standardeve që të vendosur nga BE.

Ligji aktual nuk përcakton indikatorët e detyrueshëm ESG, formatet e raportimit, kërkesat e dhënies së sigurisë, lidhjen midis raportimit financiar dhe atij të qëndrueshmërisë. Kjo krijon pasaktësi, raportim të pakrahasueshëm dhe konfuzion të përdoruesit të informacionit.

Rritja e nevojës për mbrojtjen e ndërmarrjeve të vogla në raport me zinxhirët e furnizimit. Pa rregulla të qarta, bizneset e vogla mbingarkohen nga kërkesat për informacion të tepërt. Nisma parashikon statusin e “njësive të mbrojtura”, duke ruajtur proporcionalitetin.

Forcimi i klimës së investimeve. Në mungesë të raportimeve të standardizuara dhe të verifikuara, investitorët nuk kanë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar realisht rreziqet dhe performancën e ndërmarrjeve. Kjo ul konkurueshmërinë e ekonomisë dhe pengon investimet e huaja direkte.

- ***Identifikoni shkaqet e problemit.***

Shkaqet kryesore lidhen kryesisht me zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe me sfidat e hasura në zbatimin praktik të ligjit aktual.

Së pari, një nga shkaqet kryesore është përditësimi i vazhdueshëm i *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë, i cili ka sjellë kërkesa të reja për transparencë dhe raportim nga ana e njësive ekonomike. Në veçanti, miratimi i rregullimeve të reja në nivel të Bashkimit Evropian për raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave ka zgjeruar ndjeshëm detyrimet e njësive ekonomike për të raportuar jo vetëm mbi informacionin financiar, por edhe mbi çështje mjedisore, sociale dhe të qeverisjes. Kuadri ligjor aktual në Shqipëri nuk i reflekton plotësisht këto zhvillime, duke krijuar një hendek ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe kërkesave të Bashkimit Evropian.

Së dyti, një tjetër shkak lidhet me përfshirjen e kufizuar të kërkesave për raportim jofinanciar në ligjin aktual, i cili nuk parashikon në mënyrë të detajuar detyrimet për raportimin e qëndrueshmërisë për kategori të ndryshme njësish ekonomike. Kjo situatë krijon mungesë qartësie për subjektet raportuese dhe kufizon nivelin e transparencës në lidhje me ndikimin e aktiviteteve ekonomike në mjedis dhe shoqëri.

Së treti, problematikat e evidentuara gjatë zbatimit praktik të ligjit ekzistues kanë treguar nevojën për përmirësimin e disa dispozitave ligjore. Këto problematika lidhen kryesisht me paqartësi në terminologji, me zbatimin e disa kërkesave për përgatitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare, si dhe me nevojën për harmonizimin më të mirë të dispozitave ligjore me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Një shkak tjetër lidhet me rritjen e kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie në aktivitetin ekonomik, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Investitorët, institucionet financiare dhe publiku kërkojnë gjithnjë e më shumë informacion të besueshëm dhe të krahasueshëm mbi performancën financiare dhe ndikimin e njësive ekonomike në ekonomi dhe shoqëri. Kuadri aktual ligjor nuk i adreson plotësisht këto kërkesa në përputhje me praktikën më të avancuar ndërkombëtare.

Pamjaftueshmëri në dispozitat për publikim dhe akses publik. Ligji aktual nuk siguron publikim të plotë dhe të aksesueshëm të raporteve të konsoliduara, raporteve të qëndrueshmërisë, raporteve mbi pagesat ndaj shtetit, raporteve tatimore sipas kërkesave të BE-së. Mungesa e aksesit publik ul transparencën.

Paqartësi në lidhje me përjashtimet, kufizimet dhe kërkesat specifike për ndërmarrjet e lidhura ndërkombëtarisht. Ligji aktual nuk trajton në mënyrë të plotë raportimin e njësive të kontrolluara nga kompani mëmë të huaja, përjashtimet në rastet kur ekziston raportim i konsoliduar në një vend tjetër, publikimin e raporteve të kompanive të huaja me degë në Shqipëri, rastet kur raportimi i konsoliduar nuk është i disponueshëm.

Zgjidhja e këtyre çështjeve është e domosdoshme për efekt të harmonizimit ndërkufitar të raportimit.

Ligji aktual nuk parashikon rregulla të qarta mbi ruajtjen elektronike të dokumenteve kontabël, sigurinë dhe vlefshmërinë juridike të dokumentacionit elektronik. Në praktikë kjo ka sjellë paqartësi në trajtimin ligjor të dokumenteve të nënshkruara elektronikisht, mosnjohje uniforme të bartësve elektronikë të informacionit. Duke qenë se ekonomia po digjitalizohet me ritme të shpejta, ndërmerret nisma për kryerjen e këtyre përmirësimeve.

- ***Përshkruani shtrirjen e problemit.***

Shtrirja e problemit lidhet me nivelin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor ekzistues për kontabilitetin dhe raportimin financiar me zhvillimet më të fundit të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe me kërkesat në rritje për transparencë dhe cilësi të informacionit financiar. Ligji nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përbën bazën kryesore ligjore që rregullon përgatitjen, paraqitjen dhe publikimin e pasqyrave financiare nga subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, zhvillimet e fundit në nivel ndërkombëtar dhe evropian kanë sjellë nevojën për përditësimin dhe përmirësimin e këtij kuadri ligjor.

Shtirja e problemit në nivel kombëtar

Kuadri aktual ligjor nuk përfshin në mënyrë të plotë kërkesat e reja që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë dhe raportimin jofinanciar, të cilat tashmë përbëjnë një komponent të rëndësishëm të raportimit të ndërmarrjeve në Bashkimin Evropian. Mungesa e këtyre kërkesave në legjislacionin kombëtar krijon një hendek ndërmjet standardeve të aplikueshme në Shqipëri dhe atyre të kërkuara nga *acquis* i Bashkimit Evropian.

Së dyti, shtrirja e problemit lidhet edhe me kategoritë e subjekteve që janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e raportimit. Në mungesë të një kuadri ligjor të përditësuar, ndërmarrjet raportojnë në mënyrë të ndryshme dhe jo të njëtrajtshme. Kjo krijon një terren të pabarabartë konkurrimi — disa ndërmarrje raportojnë sipas praktikave ndërkombëtare dhe të kërkuara nga partnerët e tyre, ndërsa të tjerat mbeten vetëm te kërkesat minimale ligjore.

Strukturat e monitorimit ekonomik kanë nevojë për informacion të standardizuar për analiza fiskale, kontroll të riskut makroekonomik, vlerësimin e sektorëve ekonomikë. Ligji aktual nuk u ofron atyre informacionin që kërkojnë standardet moderne të vlerësimit ekonomik.

Mungesa e dispozitave bashkëkohore për cilësinë e informacionit rrit mundësinë e rrezikut që raportet të jenë jo të plota, dhe të krijojnë perceptim të gabuar për gjendjen reale të kompanisë.

Mungesa e rregullave të qarta për ndërmarrjet e vogla në raport me ndërmarrjet e ndërmarrjet e mëdha, ku në disa raste ndërmarrjet e vogla ngarkohen me kërkesa të tëpërta të panevojshme, shkakton në këtë mënyrë kosto të panevojshme.

Në nivel ndërkombëtar

Së treti, shtrirja e problemit prek edhe cilësinë dhe krahasueshmërinë e informacionit financiar të raportuar nga subjektet ekonomike. Në disa raste, mungesa e përafrimit të plotë me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare mund të ndikojë në cilësinë e pasqyrave financiare dhe në besueshmërinë e informacionit që përdoret nga investitorët, institucionet financiare, autoritetet publike dhe palët e tjera të interesuara.

Institucionet financiare ndërkombëtare kërkojnë që kompanitë të raportojnë ESG para se të marrin financim. Ligji aktual nuk e mundëson këtë, pasi raportet ESG janë të pjesshme, nuk janë të standardizuara, nuk janë të krahasueshme me ESRS.

Vendet e BE-së kërkojnë transparencë fiskale dhe publikim të të dhënave të tatimit nga korporatat. Nëse nuk harmonizohet, kjo do të sillte vështirësi në përputhje me standardet e OECD dhe BE-së.

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

Problematika që lidhet me nevojën për rishikimin e ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” prek një gamë të gjerë aktorësh institucionalë, ekonomikë dhe profesionalë. Ndikimi i këtij kuadri ligjor shtrihet si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke përfshirë institucionet shtetërore, bizneset, profesionistët e fushës së kontabilitetit dhe auditimit, si dhe përdoruesit e informacionit financiar.

1. Qeveria dhe institucionet publike

Në mënyrë të drejtpërdrejtë preken institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave në fushën e raportimit financiar dhe kontabilitetit. Në këtë kategori përfshihen veçanërisht Ministria e Financave, institucionet rregullatore dhe

mbikëqyrëse, si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Këto institucione janë përgjegjëse për përditësimin e kuadrit ligjor, përafrimin e tij me acquis të Bashkimit Evropian dhe sigurimin e zbatimit korrekt të standardeve të raportimit financiar. Për rrjedhojë, çdo boshllëk apo mospërputhje në kuadrin aktual ligjor ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e politikave publike dhe në kapacitetin institucional për të garantuar transparencë dhe besueshmëri në raportimin financiar.

2. Bizneset dhe sektori privat

Bizneset përbëjnë një nga grupet kryesore të prekura nga ky problem, pasi ato janë subjektet që zbatojnë drejtpërdrejt kërkesat e legjislacionit për kontabilitetin dhe raportimin financiar. Njësitë ekonomike, duke përfshirë njësitë e vogla dhe të mesme, si dhe shoqëritë e mëdha, janë të detyruara të përgatisin dhe të publikojnë pasqyra financiare në përputhje me standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Mospërditësimi i kuadrit ligjor mund të ndikojë në nivelin e transparencës së raportimit financiar, në krahasueshmërinë e informacionit financiar ndërmjet njësisë ekonomike dhe në aftësinë e tyre për t'u përshtatur me kërkesat e tregjeve ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian.

3. Profesionistët dhe organizatat profesionale

Një tjetër grup i rëndësishëm i prekur përfshin profesionistët e fushës së kontabilitetit dhe auditimit, si kontabilistët e miratuar, shoqëritë e kontabilitetit, audituesit ligjorë dhe organizatat profesionale që operojnë në këtë fushë. Këta aktorë luajnë një rol kyç në zbatimin praktik të standardeve të kontabilitetit dhe në garantimin e cilësisë së informacionit financiar. Ndryshimet ose boshllëqet në kuadrin ligjor ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën e ushtrimit të profesionit, në kërkesat për trajnime dhe zhvillim profesional, si dhe në standardet që duhet të ndiqen gjatë përgatitjes dhe auditimit të pasqyrave financiare.

4. Sistemi financiar dhe investitorët

Në mënyrë të tërthortë, problemi prek edhe sistemin bankar dhe financiar, si dhe investitorët vendas dhe të huaj, të cilët mbështeten në informacionin financiar të raportuar nga bizneset për të marrë vendime ekonomike dhe investimi. Cilësia, besueshmëria dhe krahasueshmëria e pasqyrave financiare janë elementë thelbësorë për funksionimin efikas të tregjeve financiare dhe për krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm investimesh.

5. Shoqëria civile dhe publiku i gjerë

Shoqëria civile dhe publiku i gjerë përbëjnë gjithashtu një grup të prekur në mënyrë indirekte nga ky problem. Organizatat e shoqërisë civile, studiuesit, mediat dhe qytetarët përdorin informacionin financiar dhe raportimet e njësisë ekonomike për të vlerësuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e biznesit, veçanërisht në lidhje me ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të veprimtarisë së tyre.

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi i identifikuar, i cili lidhet me nevojën për përditësimin dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe raportimin financiar me zhvillimet e fundit të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes ndërhyrjes në nivel politikash.

Zhvillimet e fundit në nivel të Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë, zgjerimin e kërkesave për transparencë dhe forcimin e standardeve të raportimit financiar, kanë krijuar nevojën për përditësimin dhe përshtatjen e këtij kuadri ligjor.

Në këtë kontekst, ndërhyrja përmes ndryshimit të politikave konsiderohet si një instrument i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për të adresuar problemet e identifikuara. Përmes këtij procesi mund të sigurohet përfshirja e kërkesave të reja që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë, përmirësimi i cilësisë dhe krahasueshmërisë së informacionit financiar, si dhe zgjerimi i fushës së subjekteve që duhet të zbatojnë standardet përkatëse të raportimit.

Gjithashtu, ndërhyrja në nivel politikash mund të mundësojë harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, duke kontribuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian. Një qasje e tillë do të ndihmojë gjithashtu në forcimin e transparencës financiare, rritjen e besimit të investitorëve dhe përmirësimin e funksionimit të tregut financiar.

Nga ana tjetër, në mungesë të ndryshimeve të nevojshme në politikat dhe në legjislacionin përkatës, ekziston rreziku që kuadri aktual rregullator të mbetet i papërditësuar dhe të mos reflektojë zhvillimet e fundit ndërkombëtare në fushën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë. Kjo mund të ndikojë negativisht në nivelin e transparencës së informacionit financiar, në besueshmërinë e raporteve të publikuara nga ndërmarrjet dhe në aftësinë e sistemit ekonomik për t'u përshtatur me kërkesat e tregjeve ndërkombëtare.

Për rrjedhojë, vlerësohet se problemi i identifikuar mund dhe duhet të trajtohet përmes një ndërhyrjeje në nivel politikash.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.

Qeveria planifikon të ndërhyjë me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon raportimin financiar në Shqipëri. Ndërhyrja është e nevojshme pasi zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë, transparencën fiskale dhe kërkesat për raportimin financiar, kërkojnë përshtatjen e legjislacionit kombëtar me këto standarde të reja.

Kjo nismë është thelbësore në funksion të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë, pasi përputhshmëria me *acquis* të BE-së në fushën e raportimit financiar, transparencës së tregut, qeverisjes korporative dhe qëndrueshmërisë është një kërkesë kyçe për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me anëtarësimin e vendit në Bashkimit Evropian.

Konkretisht, zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë dhe transparencën e korporatave, kanë krijuar nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator në fuqi dhe harmonizimin me *acquis* të

Bashkimit Evropian, në mënyrë që të përfshijë elemente të raportimit të qëndrueshmërisë dhe të forcojë cilësinë e raportimit financiar në Shqipëri.

Gjithashtu, zbatimi praktik i ligjit aktual ka evidentuar disa problematika që lidhen me qartësinë e disa dispozitave, me përcaktimin e subjekteve të detyruara për raportime të caktuara dhe me nevojën për forcimin e mëtejshëm të cilësisë së raportimit financiar. =Për rrjedhojë, çdo boshllëk apo mospërputhje në kuadrin aktual ligjor ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e politikave publike dhe në kapacitetin institucional për të garantuar transparencë dhe besueshmëri në raportimin financiar. Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional, forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe rritja e koordinimit ndërinstitutional, duke kontribuar në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm, transparent dhe të besueshëm të raportimit financiar në vend. Në këtë kontekst, ndërmarrja e kësaj nisme konsiderohet i domosdoshëm për të garantuar një sistem raportimi më transparent, më të besueshëm dhe më të harmonizuar me standardet evropiane, duke sjellë përfitime për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Sistemi aktual i raportimit financiar nuk siguron në çdo rast informacion të krahasueshëm, të verifikueshëm dhe të standardizuar. Në këtë mënyrë ndërhyrja synon të garantojë që informacioni që publikohet nga ndërmarrjet të jetë i saktë, i besueshëm dhe i dobishëm për investitorët, bankat, institucionet publike dhe publikun.

Ndërhyrja bëhet e domosdoshme për të siguruar që legjislacioni të jetë në linjë me transformimin digjital të ekonomisë. Duke qenë se ligji aktual nuk adreson në mënyrë të plotë ruajtjen elektronike të dokumenteve kontabël, automatizimin e raportimit financiar, si dhe përdorimin e sistemeve të kontabilitetit, kjo ndërhyrje bëhet e domosdoshme.

Ndërhyrja synon të unifikojë standardet dhe të sigurojë krahasueshmëri horizontale ndërmjet ndërmarrjeve. Gjithashtu, kjo ndërhyrje është e domosdoshme që të sigurojë që informacioni i raportuar nga ndërmarrjet shqiptare të jetë i pranueshëm dhe krahasueshëm me raportimet e vendeve të BE-së. Në këtë kontekst, ndërmarrja e kësaj nisme konsiderohet i domosdoshëm për të garantuar një sistem raportimi më transparent, më të besueshëm dhe më të harmonizuar me standardet evropiane, duke sjellë përfitime për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces.

Për këto arsye qeveria, parashikon të ndërhyjë për të rritur cilësinë, krahasueshmërinë dhe besueshmërinë e raportimeve financiare dhe jofinanciare, duke garantuar një sistem raportimi të modernizuar, të qartë dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional, forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe rritja e koordinimit ndërinstitutional, duke kontribuar në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm, transparent dhe të besueshëm të raportimit financiar në vend.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Përmes kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të trajtojë disa çështje kryesore, si:

- përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- përfshirjen e kërkesave të reja që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet e mëdha;
- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së subjekteve ekonomike;

- përmirësimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare;
- qartësimin e terminologjisë dhe të dispozitave të ligjit për të lehtësuar zbatimin e tij në praktikë.

Në këtë mënyrë synohet krijimi i një sistemi më të besueshëm dhe më transparent të raportimit financiar, i cili do të kontribuojë në forcimin e qeverisjes së brendshme të ndërmarrjeve dhe në rritjen e besimit të investitorëve.

Përmes kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të trajtojë një sërë çështjesh strukturore dhe funksionale që lidhen me përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar dhe kontabilitetit në vend. Kjo nismë synon të adresojë nevojën për modernizimin e legjislacionit ekzistues, përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar dhe rritjen e transparencës në aktivitetin ekonomik, në përputhje me zhvillimet më të fundit në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Në mënyrë më konkrete, ndërhyrja synon:

- Përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimi Evropian në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke reflektuar ndryshimet më të fundit në direktivat evropiane dhe standardet ndërkombëtare. Ky përafrim synon të përmirësojë harmonizimin e praktikave të raportimit financiar në Shqipëri me ato të vendeve të BE-së, duke lehtësuar gjithashtu procesin e integritetit evropian dhe rritjen e besueshmërisë së tregut shqiptar për investitorët e huaj.
- Përfshirjen e kërkesave të reja që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet e mëdha dhe subjektet me interes publik, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e raportimit jofinanciar. Këto kërkesa synojnë rritjen e transparencës mbi ndikimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG), duke mundësuar një vlerësim më të plotë të performancës së ndërmarrjeve dhe të rreziqeve afatgjata që lidhen me aktivitetin e tyre.
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së subjekteve ekonomike, përmes përmirësimit të kërkesave për raportimin financiar dhe publikimin e informacionit financiar. Kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit të investitorëve, kreditorëve, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë, si dhe në përmirësimin e klimës së biznesit.
- Përmirësimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, përmes përcaktimit më të qartë të kërkesave të raportimit dhe përditësimit të kuadrit rregullator. Kjo do të mundësojë që informacioni financiar të jetë më i saktë, më i plotë dhe më i dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të palëve të interesuara.
- Qartësimin e terminologjisë dhe të dispozitave të ligjit për të lehtësuar zbatimin e tij në praktikë, si dhe për të shmangur interpretimet e ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit të tij. Kjo do të ndihmojë në rritjen e sigurisë juridike dhe në përmirësimin e zbatimit të ligjit nga subjektet raportuese dhe institucionet mbikëqyrëse.

Gjithashtu, përmes kësaj ndërhyrjeje synohet forcimi i rolit të institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, si dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë, kjo nismë synon rritjen e kapaciteteve profesionale të aktorëve të përfshirë në procesin e raportimit financiar, përfshirë profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit.

Në këtë mënyrë synohet krijimi i një sistemi më të besueshëm, më transparent dhe më të qëndrueshëm të raportimit financiar, i cili do të kontribuojë në forcimin e qeverisjes së

brendshme të ndërmarrjeve, në përmirësimin e klimës së biznesit dhe në rritjen e besimit të investitorëve vendas dhe të huaj. Në një perspektivë më të gjerë, kjo ndërhyrje do të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit dhe integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*

Ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e moderuar, pasi nuk synon ndryshimin rrënjësor të sistemit aktual të kontabilitetit dhe raportimit financiar, por përmirësimin dhe përshtatjen e tij me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare dhe me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Ndryshimet synojnë të rrisin efektivitetin e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në sistemin e raportimit financiar.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat strategjike të qeverisë për integrimin evropian dhe për forcimin e institucioneve ekonomike dhe financiare në vend. Në mënyrë të veçantë, ajo kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, konkretisht nga Kapitulli 6 i acquis-së “Legjislacioni tregtar”, i cili përfshin rregullat për raportimin financiar dhe transparencën e pasqyrave financiare.

Gjithashtu, ndërhyrja mbështet objektivat e qeverisë për rritjen e transparencës, përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin e një ekonomie më të qëndrueshme dhe konkurruese.

Nisma lidhet drejtpërdrejtë me disa dokumente politike të rëndësisë së lartë siç janë:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) – dokumenti kryesor strategjik që përcakton prioritetet e zhvillimit ekonomik, forcimin e institucioneve dhe integrimin në BE.

Programi i Qeverisë së Shqipërisë 2021–2025, ku përfshihen objektiva për rritjen e transparencës, përmirësimin e klimës së biznesit dhe zhvillimin ekonomik.

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, që synon forcimin e raportimit financiar, transparencës dhe llogaridhënies në financat publike.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në kuadër të reformës për përmirësimin e raportimit financiar janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe reformash, ndër të cilat përfshihen:

- përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor;

Kuadri ligjor në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar është përmirësuar vazhdimisht gjatë viteve, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare dhe kërkesat e procesit të integritetit evropian. Në këtë kuadër, është miratuar dhe përditësuar ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe ligji për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe

kontabilistit të miratuar. Ndër vite janë ndërmarrë ndryshime të rëndësishme ligjore për të reflektuar direktivat e Bashkimi Evropian, për të përcaktuar më qartë kërkesat e raportimit financiar për ndërmarrjet sipas madhësisë dhe interesit publik, si dhe për të rritur transparencën dhe cilësinë e raportimit financiar. Gjithashtu, në zbatim të këtyre ligjeve janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, udhëzimesh dhe rregulloresh që përcaktojnë formatet e pasqyrave financiare, kërkesat e raportimit dhe procedurat e zbatimit të standardeve kontabël. Këto ndryshime kanë kontribuar në modernizimin e sistemit të raportimit financiar dhe në harmonizimin e tij me praktikat ndërkombëtare.

- forcimi i rolit dhe kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit në zhvillimin dhe përditësimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit;

Roli i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit është forcuar gradualisht përmes zgjerimit të kompetencave të tij dhe rritjes së kapaciteteve profesionale. Ky institucion ka zhvilluar dhe përditësuar standardet kombëtare të kontabilitetit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka përmirësuar procesin e konsultimit publik gjatë hartimit të standardeve, duke përfshirë aktorët kryesorë të sistemit financiar dhe komunitetin profesional. Përveç kësaj, ky institucion ka rritur rolin e tij në interpretimin e standardeve, në ofrimin e udhëzimeve metodologjike dhe në mbështetjen e subjekteve raportuese për zbatimin e kërkesave të reja të raportimit financiar.

- mbështetja e organizatave profesionale të kontabilistëve dhe audituesve për përmirësimin e proceseve dhe standardeve profesionale;

Mbështetja e organizatave profesionale është realizuar përmes bashkëpunimit institucional, zhvillimit të programeve të përbashkëta të trajnimit dhe përfshirjes së tyre në proceset konsultative për hartimin e legjislacionit dhe standardeve të reja. Organizatat profesionale kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së profesionit përmes zhvillimit të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional, përmirësimit të kodeve të etikës dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit të cilësisë. Kjo mbështetje ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të kontabilistëve dhe audituesve, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

- zhvillimi i kapaciteteve institucionale të rregullatorëve dhe institucioneve përkatëse, përfshirë Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe administratën tatimore;

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë masa për rritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të këtyre institucioneve, përmes trajnimeve, përmirësimit të procedurave të mbikëqyrjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Këto institucione kanë përmirësuar metodologjitë e monitorimit të raportimit financiar, kanë zhvilluar udhëzime për subjektet e mbikëqyrura dhe kanë forcuar kontrollin për përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve mbikëqyrëse.

- përmirësimi i sistemit të regjistrimit dhe publikimit të pasqyrave financiare nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë masa për rritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të këtyre institucioneve, përmes trajnimeve, përmirësimit të procedurave të mbikëqyrjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional. Këto institucione kanë përmirësuar metodologjitë e monitorimit të raportimit financiar, kanë zhvilluar udhëzime për subjektet e mbikëqyrura dhe kanë forcuar kontrollet për përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve mbikëqyrëse.

- zhvillimi i programeve të trajnimit dhe edukimit në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionet e arsimit të lartë;

Institucionet e arsimit të lartë kanë përditësuar programet mësimore në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Janë zhvilluar programe të reja studimi, kurse profesionale dhe trajnime të specializuara, me fokus në standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe praktikat moderne të kontabilitetit. Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe institucioneve publike për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të studentëve dhe profesionistëve të rinj.

- ndërmarrja e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e raportimit financiar dhe të kontabilitetit cilësor.

Janë organizuar aktivitete informuese, konferenca, seminare dhe fushata ndërgjegjësimi për bizneset dhe publikun e gjerë mbi rëndësinë e raportimit financiar cilësor dhe transparent. Këto aktivitete kanë synuar rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet e transparencës financiare, përmirësimin e kulturës së raportimit financiar dhe forcimin e besimit të investitorëve dhe palëve të interesuara. Gjithashtu, janë zhvilluar materiale udhëzuese dhe informuese për subjektet raportuese për të lehtësuar zbatimin e kërkesave ligjore.

Në tërësi, këto reforma dhe aktivitete kanë kontribuar në forcimin e sistemit të raportimit financiar në vend, në rritjen e transparencës dhe në përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian të vendit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
1. Përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në kapitullin 6 të acquis-së ku pjesa kryesore i përket raportimit të qëndrueshmërisë, brenda vitit 2026;

2. Përcaktimi i qartë i njësive që janë të detyruara të kryejnë raportimin e qëndrueshmërisë;
3. Përmirësimi i dhe forcimi i rregullave për raportimin financiar të njësive me interes publik (NJEIP);
4. Sigurimi i qartësisë më të plotë të kërkesave ligjore për informacionin mbi fitimin dhe tatimet e paguara nga korporatat e mëdha shumëkombëshe të BE-së dhe ato jo-BE që kanë filiale që operojnë në BE, në përputhje me direktivën përkatëse, brenda vitit 2027, me qëllim rritjen e qartësisë rregullatore dhe harmonizimin e raportimit financiar.
5. Qartësimi dhe unifikimi i terminologjive përkatëse, brenda vitit 2027, me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së dispozitave dhe rritjen e qartësisë në interpretimin e tyre nga subjektet raportuese.
6. Rritja e cilësisë së raportimit financiar duke siguruar që të gjitha njësitë ekonomike t'i hartojnë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ose me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
7. Standardizimi i përbërësve minimalë të pasqyrave financiare për çdo kategori njësie ekonomike (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha), me qëllim rritjen e uniformitetit, krahasueshmërisë dhe cilësisë së raportimit financiar, brenda vitit 2027.
8. Vendosja e detyrimit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve të paktën një herë në vit nga të gjitha njësitë ekonomike, me qëllim përmirësimin e saktësisë së pasqyrave financiare dhe rritjen e besueshmërisë së raportimit financiar, brenda vitit 2027.
9. Vendosja e sistemit të detyrueshëm të raportimit të qëndrueshmërisë për ndërmarrjet që tejkalojnë 1 000 punonjës dhe 450 milionë euro të ardhura neto, që nga perioda raportuese 2028;
10. Rritja e transparencës së raportimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, ku njësitë e mesme, të mëdha dhe ato me interes publik detyrohen të publikojnë pasqyrat financiare në faqen zyrtare të internetit brenda 7 muajve;
11. Rregullimi i mënyrës së raportimit financiar për degët dhe njësitë ekonomike të huaja që operojnë në Shqipëri, në rastet kur raporti i konsoliduar i shoqërisë mëmë nuk është i disponueshëm, me qëllim sigurimin e raportimit të plotë, të krahasueshëm dhe të zbatueshëm në praktikë;
12. Vendosja e detyrimit për raportim "Country by Country" të tatimit mbi të ardhurat për njësitë ekonomike shumëkombëshe që tejkalojnë pragun e 750 milionë eurove të ardhura në dy vite radhazi, me synim rritjen e transparencës fiskale dhe përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian, brenda vitit 2027.
13. Sigurimi i një sistemi të unifikuar, të digjitalizuar dhe të besueshëm kontabël, ku detyrohet ruajtja e dokumenteve kontabël për të paktën 5 vite;
14. Forcimi i integritetit të dhënave përmes rregullave të qarta të regjistrimit kronologjik dhe sistematik;
15. Sigurimi që raportet e qëndrueshmërisë të hartohen plotësisht në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS), me synim rritjen e cilësisë, krahasueshmërisë dhe harmonizimit të raportimit jofinanciar me kërkesat e Bashkimit Evropian, brenda vitit 2027;
16. Vendosja e detyrimit për verifikim të kufizuar (limited assurance) të raporteve të qëndrueshmërisë nga audituesit ligjorë, brenda vitit 2027;

Këto objektiva synojnë përmirësimin e transparencës, rritjen e cilësisë së raportimit financiar dhe forcimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. Një objektiv kryesor është përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar për kontabilitetin dhe raportimin financiar me *acquis* të Bashkimit Evropian. Ky objektiv synon të sigurojë që kuadri ligjor shqiptar të jetë në përputhje me direktivat më të fundit të Bashkimit Evropian në këtë fushë, duke përfshirë kërkesat për raportimin e qëndrueshmërisë, transparencën fiskale dhe përmirësimin e raportimit financiar të ndërmarrjeve të mëdha dhe të njësive me interes publik. Realizimi i këtij objektivi është planifikuar të arrihet përmes miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve ligjore brenda periudhës së parashikuar në planin kombëtar për integrimin evropian.

Një objektiv tjetër është përmirësimi i cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare të përgatitura nga subjektet ekonomike në Shqipëri. Ky objektiv synon forcimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe standardeve kombëtare të kontabilitetit, duke mundësuar që pasqyrat financiare të jenë më të besueshme, më transparente dhe më të krahasueshme me ato të vendeve të tjera. Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar pritet të kontribuojë gjithashtu në rritjen e besimit të investitorëve dhe institucioneve financiare.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Në kuadër të procesit të hartimit të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, janë shqyrtuar disa opsione politike dhe rregullatore me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara në kuadrin aktual ligjor dhe përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e raportimit financiar.

Opsioni 0: Status quo (mosndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues)

Ky nuk është opsioni i përshtatshëm për arsyet si vijon:

- **Shqipëria nuk do të mund të përmbushë përafrimin me *acquis* të BE-së**, duke qenë se Direktiva 2013/34/BE dhe ndryshimet e saj nuk janë të transpozuar plotësisht në ligjin aktual. Në këtë mënyrë mosmiratimi i kësaj nisme do të pengonte përmbushjen e detyrimeve të Integritimit Evropian.
- Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë nuk janë të parashikuara në kuadrin aktual. Ndërmarrjet shqiptare mbeten jashtë tregjeve europiane, të cilat pengohen të hyjnë në kontrata me zinxhirët europianë, si dhe rritet rreziku i mospërputhshmërisë me kërkesat e investitorëve ndërkombëtarë.
- Ligji aktual nuk garanton procese të standardizuara, rregulla të qarta për ruajtjen e dokumenteve, si dhe kërkesa të avancuara të raportimit të konsoliduar.

Avantazhet

- Nuk krijon ngarkesë shtesë administrative, si në burime njerëzore apo materiale, si dhe nuk ka nevojë të krijohen sisteme të reja, apo portale të reja.
- Bizneset nuk duhet të adaptojnë standarde të reja, të përgatisin raporte shtesë, apo të trajnohen.

Opsioni 1 (jo rregullator) -nënkupton marrjen e masave jorregullore si rritja e kontrolleve dhe kryerja e fushatave ndërgjegjëse.

Ky opsion nuk mund të aplikohet për arsye se:

Problemet aktuale janë të natyrës rregullore. Harmonizimi me standardet e Bashkimit Evropian nuk mund të arrihet vetëm nëpërmjet trajnimeve, fushatave apo kontrolleve, por kërkohet një bazë e re ligjore.

Ligji ekzistues ka disa problematika si klasifikim i vjetruar i njësive ekonomike, mungesë e detyrimeve të reja të transparencës, mungesë rregullash për raportimin konsoliduar të qëndrueshmërisë. Këto **nuk mund të rregullohen me masa jorregullore.**

Standardet e reja (ESRS, IFRS të përditësuara) nuk mund të bëhen të detyrueshme pa ndryshim ligjor.

Për më tepër, mungesa e standardeve ligjore të raportimit të qëndrueshmërisë dhe transparencës tashmë krijon rrezik për investitorët e huaj, për qasjen në tregun e BE-së, për vlerësimet ndërkombëtare të vendit.

Avantazhet

Zbatim i shpejtë dhe fleksibël, ku masat jorregullore mund të zbatohen menjëherë pa procedura ligjore për miratimin e tyre.

Kosto më e ulët administrative, ku institucionet nuk kanë nevojë të krijojnë mekanizma të rinj ligjorë, sisteme raportimi apo struktura të reja.

Mund të rrisë ndërgjegjësimin, ku fushatat, trajnimet dhe komunikimet ndihmojnë bizneset të kuptojnë standardet ekzistuese.

Opsioni 2 (rregullator) i preferuar:– nënkupton ndryshimin e ligjit ekzistues, konkretisht ligjit nr.25/2018, *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*.

Ky është opsioni më i përshatshëm për t’u zbatuar, për arsye se nëpërmjet nismës së propozuar do të mundësohet do të arrihen objektivat e synuar, pasi dispozitat aktuale të ligjit do të ndryshohen në përshtatje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Opsioni 2 vlerësohet si opsioni më i përshtatshëm për t'u zbatuar, për arsye se nëpërmjet nismës së propozuar nuk do të kryhen ndryshime që prekin të gjithë apo pjesën më të madhe të dispozitave të ligjit në tërësi, por do të mundësohet kryerja e disa saktësimeve dhe shtesave në dispozitat aktuale të këtij ligji. Për rrjedhojë duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk do të prekin më shumë se 50% të ligjit aktual në tërësi, në kuadër të teknikës legjislativë, opsioni 2 rezulton si opsion më i përshtatshëm. Kjo siguron koherencë, qartësi dhe vazhdimësi në legjislacion, duke shmangur nevojën për të ristrukturuar të gjithë aktin dhe për të ndryshuar në mënyrë të panevojshme strukturën e tij themelore.

Pjesa më e madhe e dispozitave themelore, parimeve dhe mekanizmave ekzistues ruhet, ndërsa ndryshimet fokusohen në shtesa dhe riformulime që lidhen drejtpërdrejt me përafrimin me *acquis* të BE-së. Dispozitat e reja janë të integruar si nene shtesë, pa cenuar strukturën themelore të ligjit. Kjo tregon se ndërhyrjet **nuk justifikojnë për hartimin e një ligji krejtësisht të ri**, por përkundrazi konfirmojnë se opsioni i duhur është ai rregullator: ndryshimi i ligjit ekzistues.

Për më tepër, ruajtja e ligjit bazë dhe ndërhyrjet përmes shtesave e ndryshimeve siguron **vazhdimësi juridike**, shmang boshllëqet, shmang konfuzionin të subjektet e zbatimit dhe i jep kohë subjekteve të përshtaten me detyrimet e reja.

Opsioni rregullator – ndryshimi i ligjit nr.25/2018 – është opsioni më i përshtatshëm pasi natyra e ndryshimeve të nevojshme është plotësisht **rregullatore** dhe këto ndryshime nuk mund të adresohen me mjete jorregullatore.

Ligji aktual nuk përmban konceptet e reja të raportimit të qëndrueshmërisë (ESG), standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS), detyrimet e reja të grupeve. Këto kërkesa burojnë drejtpërdrejt nga direktivat e Bashkimit Europian, të cilat kërkojnë përafrim të plotë ligjor, duke bërë të domosdoshëm ndërhyrjen në ligjin bazë.

Avantazhet

Përafrim i plotë me *acquis* të BE-së. Nisma e propozuar për ndryshimin e ligjit është e domosdoshëm për të siguruar përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së, në veçanti me kërkesat e zgjeruara të Direktivës CSRD dhe me standardet ESRS të hartuara nga EFRAG, të cilat prekin drejtpërdrejt mënyrën e raportimit jofinanciar dhe strukturën e informacionit të detyrueshëm.

Modernizim i kornizës kombëtare të kontabilitetit. Ligji ekzistues i vitit 2018 nuk përfshin konceptet bashkëkohore të qeverisjes korporative, raportimit të qëndrueshmërisë, zinxhirit të vlerës, publikimit të detajuar, standardeve vullnetare dhe as mekanizma të rinj të konsolidimit. Vendosja e dispozitave të reja mbi raportimin ESG, verifikimin e raporteve të qëndrueshmërisë, raportimin e tatimit mbi të ardhurat dhe rregullat e detajuara të konsolidimit përbën një modernizim struktural, jo thjesht procedural.

Rritje e transparencës, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së informacionit. Raportimi i qëndrueshmërisë, informacioni ESG, raportet e detyrueshme të zinxhirit të vlerës dhe

raportimi i publik i tatimit mbi të ardhurat krijojnë një nivel të ri transparence për bizneset, duke bërë të mundur që investitorët, konsumatorët dhe institucionet të kenë qasje më të plotë të informacioni për performancën dhe përgjegjshmërinë e ndërmarrjeve. Kjo përmirëson qartësinë e informacionit financiar dhe jofinanciar dhe rrjedhimisht ul rrezikun e keqinformimit

Përmirësim i klimës së biznesit dhe tërheqje e investimeve. Transparenca e shtuar, përputhshmëria me standardet europiane dhe rritja e cilësisë së raportimit e bëjnë Shqipërinë një destinacion më të sigurt për investitorët e huaj dhe vendas. Harmonizimi me standardet ESRS dhe me kërkesat e BE-së i jep investitorëve siguri se raportet e subjekteve shqiptare janë të krahasueshme me ato të ndërmarrjeve europiane.

Mbrojtja e bizneseve të vogla dhe të mesme nga ngarkesa të panevojshme. Fakti se subjekti raportues nuk mund të kërkojë të dhëna shtesë që tejkalojnë këto standarde, ul ndjeshëm barrën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo qasje e balancuar ruan konkurrueshmërinë e tyre, shmang kosto të panevojshme dhe siguron që barra e raportimit të fokusohet kryesisht te ndërmarrjet e mëdha dhe grupet me ndikim të rëndësishëm ekonomik.

Periudha të qarta tranzitore, ku detyrimet për raportimin e qëndrueshmërisë dhe për raportimin e tatimit mbi të ardhurat bëhen të detyrueshme duke filluar nga periudhat raportuese 2028. Kjo qasje u jep ndërmarrjeve kohë të mjaftueshme për të ngritur kapacitetet e tyre të brendshme, për t'u pajisur me sistemet e duhura të teknologjisë së informacionit, për të trajnuar stafin dhe për të vendosur praktikatat e mbledhjes së të dhënave.

Kohë më e shkurtër për miratim dhe zbatim krahasuar me hartimin e një ligji të ri.

Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 25/2018 mundëson procedura më të shpejta legjislative, pasi nuk kërkon hartimin nga e para të një kuadri të ri ligjor, por vetëm rishikimin dhe plotësimin e dispozitave ekzistuese. Kjo redukton ndjeshëm kohën e nevojshme për konsultim, miratim dhe hyrje në fuqi të ndryshimeve, duke mundësuar implementimin më të shpejtë të kërkesave të reja të acquis-it të BE-së.

Kosto më të ulëta administrative dhe institucionale.

Zbatimi i opsionit rregullator sjell kosto më të ulëta në krahasim me hartimin e një ligji të ri, pasi shmang nevojën për ristrukturim të plotë të kuadrit ligjor dhe institucional. Përditësimi i dispozitave ekzistuese kërkon më pak burime njerëzore dhe financiare nga administrata publike dhe lehtëson përshtatjen e subjekteve raportuese, duke reduktuar kostot e tranzicionit dhe të zbatimit.

Disavantazhet

Biznest veçanërisht ato të mëdha dhe grupet, duhet të sigurojnë, përgatitjen e raporteve të qëndrueshmërisë, përmirësimin e proceseve të kontabilitetit dhe pagesën e verifikimit të detyrueshëm nga audituesit. Këto kosto mund të ndikojnë në efikasitetin financiar të subjekteve në fazat e para të zbatimit.

Subjektet duhet të kuptojnë dhe zbatojnë standarde të detajuara të ESRS, procedura verifikimi dhe kërkesa të reja për publikim. Kjo rrit mund të krijojë vështirësi interpretimi.

Nevoja për trajnim si për profesionistët e kontabilitetit, audituesit, ashtu edhe subjektet që përfshihen në fushën e detyrimeve.

Opsioni 3 (rregullator): – Miratimi i një ligji të ri në fushën e raportimit financiar. Ky opsion nuk është i përshtatshëm, për arsye se ndryshimet që synohen të ndërmerren për zgjidhjen e problematikave të evidentuara, nuk ndikojnë në thelbin e ligjit ekzistues dhe për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera.

Opsioni që parashikon miratimin e një ligji të ri nuk konsiderohet i përshtatshëm, sepse ndërhyrjet që synohen të ndërmerren me këtë reformë nuk prekin thelbin, strukturën dhe parimet bazë të ligjit nr. 25/2018. Ndryshimet e propozuara kanë natyrë harmonizuese dhe përshtatëse, të cilat synojnë integrimin e kërkesave të reja të BE-së pa ndryshuar strukturën ligjore ekzistuese.

Duke qenë se ndryshimet nuk tejkalojnë rreth 50% të dispozitave të ligjit, ndërhyrja nuk mund të realizohet me hartimin e një ligji të ri. Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri do të ishte një ndërhyrje disproporcionale, e panevojshme nga pikëpamja teknike dhe më e kushtueshme në burime njerëzore, materiale dhe kohore. Për më tepër, hartimi i një ligji të ri do të kërkonte ristrukturimin e plotë të të gjithë kuadrit ekzistues, kjo do të sillte një barrë shtesë të konsiderueshme për administratën publike dhe për subjektet ekonomike, të cilat do të duhej të përshtateshin jo vetëm me kërkesat e reja të BE-së, por edhe me një arkitekturë të re ligjore, ndryshe nga ajo aktuale.

Avantazhet

Krijon një kornizë të re ligjore, plotësisht të harmonizuar me standardet e BE-së.

Fleksibilitet për të rishikuar strukturën ligjore. Nisma për hartimin e një ligji të ri do të mundësonte rindërtimin e kapitujve, ndarjen e përgjegjësisë dhe një logjikë të re sistematike.

Disavantazhet

Ndryshimet aktuale nuk e justifikojnë hartimin e një ligji të ri duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të ligjit aktual dhe nuk ndryshojnë strukturën bazë të ligjit ekzistues. Kjo e bën hartimin e një ligji të ri të pajustifikuar nga ana e teknikës legjislative.

Kosto shumë më të lartë në burime njerëzore, materiale dhe financiare duke qenë se do të rishikohej ligji në tërësi, kjo do të sillte pengesa të shumëta gjatë përshtajës së tij/ hartimit, si dhe do të kërkonte investim të konsiderueshëm si në burime njerëzore, materiale dhe financiare.

Kosto e lartë për subjektet ekonomike. Bizneset do të duhej, të trajnojnë stafin, të ndryshojnë sistemet e brendshme, të përditësojnë politikat, gjë që krijon barrë të panevojshme .

Nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes ligjore. Duke qenë se objektivat mund të arrihet përmes ndryshimeve në ligjin aktual, hartimi i një ligji të ri është i pajustificueshem.

Mund të krijojë vonesa në procesin e përafrimit ligjor me BE-në. Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri kërkon më tepër kohë dhe kjo do të ndikonte duke rrezikuar afatet për transpozimin e kërkesave të CSRD dhe ESRS.

Opsionet e mësipërme janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë nevojën për të adresuar problematikat e identifikuar në kuadrin aktual ligjor, kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë.

Pas analizimit të përfitimeve dhe kostove të secilit option, është vlerësuar se optioni i ndryshimit të ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara (Optioni 2) përfaqëson alternativën më të përshtatshme dhe më efektive për arritjen e objektivave të reformës. Ky option mundëson një përafrim të mëtejshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke ruajtur stabilitetin e kuadrit ligjor ekzistues dhe duke minimizuar kostot administrative dhe institucionale.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Në kuadër të analizës së projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, është kryer një vlerësim i ndikimeve që mund të sjellë optioni i preferuar (ndryshimi i ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara). Kjo analizë merr në konsideratë grupet kryesore të interesit që preken nga kjo nismë dhe llojet e ndikimeve që do të kenë mbi secilin prej tyre.

Grupet kryesore të prekura

Nga zbatimi i projektligjit pritet të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi disa grupe kryesore aktorësh që veprojnë në fushën e raportimit financiar dhe të kontabilitetit.

Grupet e prekura drejtpërdrejt:

- kontabilistët e miratuar;
- shoqëritë e kontabilitetit;
- audituesit ligjorë;
- organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit;
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK).

Grupet e prekura jo drejtpërdrejt:

- institucionet shtetërore dhe administrata publike;
- sistemi bankar dhe financiar;
- bizneset dhe ndërmarrjet që përgatisin pasqyra financiare;
- investitorët e brendshëm dhe të huaj;

- publiku i gjerë dhe përdoruesit e informacionit financiar.

1. Ndikimet ekonomike

Ndikime të drejtpërdrejta:

- përmirësimi i cilësisë, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së informacionit financiar;
- rritja e transparencës në raportimin financiar dhe jofinanciar (përfshirë raportimin e qëndrueshmërisë);
- rritja e kërkesave për përputhshmëri nga ana e bizneseve.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- përmirësimi i klimës së investimeve dhe rritja e besimit të investitorëve;
- rritja e konkurrencës së tregut dhe eficiencës ekonomike;
- lehtësimi i aksesit në financim për bizneset për shkak të informacionit më cilësor;
- integrim më i mirë në tregjet ndërkombëtare dhe përafrim me standardet e BE-së.

2. Ndikimet mbi tregun e punës dhe profesionin

Ndikime të drejtpërdrejta:

- rritja e kërkesës për ekspertizë të specializuar, veçanërisht në raportimin e qëndrueshmërisë (ESG);
- nevoja për zhvillimin e aftësive të reja profesionale në kontabilitet dhe auditim;
- rritja e kërkesave për trajnime dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- transformimi i tregut të shërbimeve profesionale (zgjerim i shërbimeve në raportim jofinanciar);
- rritja e reputacionit dhe profesionalizmit të profesionit të kontabilistit dhe audituesit;
- krijimi i mundësive të reja punësimi në fusha të specializuara.

3. Ndikimet mbi dixhitalizimin

Ndikime të drejtpërdrejta:

- nevoja për zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve digjitale për raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë;
- standardizimi i të dhënave dhe proceseve të raportimit.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- përmirësimi i infrastrukturës së raportimit financiar në nivel kombëtar;
- rritja e efikasitetit në përpunimin dhe analizimin e të dhënave;
- nxitja e inovacionit në shërbimet financiare dhe të kontabilitetit.

4. Ndikimet financiare

Ndikime të drejtpërdrejta:

- kosto fillestare për bizneset dhe profesionistët për përshtatjen me kërkesat e reja (p.sh. sisteme, trajnime, konsulencë);
- kosto për organizatat profesionale për zhvillimin e programeve të reja të trajnimit;
- kosto për institucionet publike për forcimin e kapaciteteve administrative dhe mbikëqyrëse.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- ulje e kostove afatgjata për shkak të standardizimit dhe eficiencës më të lartë;
- përfitime ekonomike nga rritja e besimit dhe transparencës në treg.

5. Ndikimet sociale

Ndikime të drejtpërdrejta:

- rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në raportimin financiar;
- përmirësimi i aksesit të publikut në informacion të besueshëm financiar.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- rritja e besimit të publikut në institucionet dhe tregjet financiare;
- forcimi i integritetit dhe etikës në profesionet financiare;
- ndikim pozitiv në perceptimin e përgjithshëm të klimës ekonomike.

6. Ndikimet institucionale

Ndikime të drejtpërdrejta:

- rritja e përgjegjësiwe për institucionet publike (Ministria e Financave, organet rregullatore dhe mbikëqyrëse);
- nevoja për përditësimin e kuadrit nënligjor dhe procedurave administrative;
- forcimi i rolit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional;
- rritja e kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- konsolidimi i sistemit të raportimit financiar në nivel kombëtar.

Në tërësi, ndryshimet e propozuara pritet të kenë ndikim pozitiv në sistemin e raportimit financiar, duke kontribuar në rritjen e transparencës, përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar dhe forcimin e klimës së investimeve.

Ndikimet financiare janë kryesisht afatshkurtra dhe lidhen me kostot e përshtatjes, ndërsa përfitimet ekonomike, institucionale dhe sociale pritet të materializohen në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Ndikimet mbi grupet e prekura

1. Kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë e kontabilitetit/ Audituesit Ligjorë

Këta aktorë janë ndër grupet më të prekura nga ndryshimet e propozuara, pasi ata janë përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike.

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
 - rritje e përgjegjësisë profesionale në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të qëndrueshmërisë;
 - nevojë për përditësim të vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe trajnime mbi kërkesat e reja ligjore dhe standardet ndërkombëtare;
 - përmirësim i cilësisë së shërbimeve profesionale të ofruara në treg.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
 - rritje e reputacionit dhe besueshmërisë së profesionit të kontabilistit;
 - zgjerim i mundësive profesionale në fushën e raportimit financiar dhe të raportimit të qëndrueshmërisë.

2. Organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit

Organizatat profesionale që përfaqësojnë kontabilistët dhe audituesit ligjorë do të kenë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të reformës.

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
 - nevoja për zhvillimin e programeve të reja të trajnimit dhe certifikimit për anëtarët e tyre;
 - përmirësim i mekanizmave të mbikëqyrjes profesionale dhe të kontrollit të cilësisë.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
 - rritje e rolit të tyre në zhvillimin e profesionit dhe në garantimin e standardeve të larta profesionale.

3. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

Ky institucion ka një rol kyç në zhvillimin dhe përditësimin e standardeve të kontabilitetit në vend.

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
 - rritje e përgjegjësisë për përditësimin dhe harmonizimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit me standardet ndërkombëtare;
 - forcim i rolit të tij institucional në kuadër të reformës së raportimit financiar.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
 - rritje e kapaciteteve institucionale dhe e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare.

Ndryshimet e propozuara në kuadrin ligjor ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e institucioneve si Ministria e Financave, institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse, pasi ato do të angazhohen në rishikimin dhe përditësimin e politikave, procedurave dhe praktikave ekzistuese, në mënyrë që të garantohet përputhshmëria me kërkesat e reja ligjore. Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse do të kenë nevojë të forcojnë kapacitetet e tyre administrative dhe teknike, si dhe të përmirësojnë koordinimin ndërinstitucional për zbatimin efektiv të ndryshimeve.

4. Bizneset dhe njësitë ekonomike

Njësitë ekonomike që përgatisin pasqyra financiare janë përdoruesit kryesorë të kuadrit ligjor të kontabilitetit.

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
 - përmirësim i kërkesave për raportim financiar dhe jofinanciar;
 - detyrime shtesë për njësitë e mëdha lidhur me raportimin e qëndrueshmërisë;
 - rritje e transparencës dhe përgjegjshmërisë në raportimin financiar.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
 - përmirësim i qeverisjes së brendshme të njësive ekonomike;
 - rritje e besimit të palëve të interesit në informacionin financiar të publikuar.

5. Sistemi bankar dhe investitorët

Institucionet financiare dhe investitorët janë përdorues të rëndësishëm të informacionit financiar të prodhuar nga njësitë ekonomike.

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
 - përfitim nga informacion financiar më i saktë, më i krahasueshëm dhe më transparent.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
 - përmirësim i procesit të vendimmarrjes për investime dhe financim;
 - rritje e besimit në tregun financiar dhe në ekonominë e vendit.

Në tërësi, ndryshimet e propozuara në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare pritet të kenë një ndikim pozitiv në funksionimin e sistemit të raportimit financiar në Shqipëri. Ndikimet kryesore lidhen me rritjen e transparencës, përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar, forcimin e profesionit të kontabilitetit dhe përmirësimin e klimës së investimeve në vend.

Ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” nuk parashikojnë krijimin e institucioneve të reja, shtimin e strukturave administrative apo fondeve të dedikuara nga buxheti i shtetit. Projektligji konsiston kryesisht në përditësime dhe përmirësime të kuadrit ekzistues rregullator, me qëllim përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe rritjen e cilësisë së raportimit financiar.

Në këtë kuadër:

1. Nuk krijohen kosto të reja buxhetore strukturore pasi nuk parashikohet:

- ngritje institucionesh të reja;
- rritje organike e stafit në administratën publike;
- fonde të reja të detyrueshme nga buxheti i shtetit.
- Institucionet ekzistuese (si Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit) do të vijojnë funksionet e tyre brenda burimeve aktuale.

2. Kostot e identifikuara janë kryesisht private dhe jo publike

- kostot kryesore lidhen me:
 - bizneset,
 - kontabilistët,
 - audituesit,

- organizatat profesionale.

Këto janë **kosto përputhshmërie** dhe nuk përbëjnë shpenzime për buxhetin e shtetit.

3. Kostot administrative janë të përballueshme brenda kapaciteteve ekzistuese

Edhe pse:

- kërkohet përditësim i procedurave,
- forcim i kapaciteteve, këto:
- realizohen përmes rishpërndarjes së burimeve ekzistuese;
- nuk kërkojnë financim shtesë të dedikuar.

Pra kemi të bëjmë me kosto operative minimale, jo me ndikim buxhetor të mirëfilltë.

4. Pjesa më e madhe e zbatimit realizohet përmes akteve ekzistuese

- Zbatimi teknik bëhet përmes:
 - standardeve të kontabilitetit,
 - akteve të Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Nuk kërkohet program i ri financiar apo skemë subvencionimi nga shteti.

Projektligji nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit, pasi nuk shoqërohet me shpenzime shtesë buxhetore, krijim strukturash të reja apo rritje të detyrueshme të financimit publik. Kostot e identifikuar lidhen kryesisht me aktorët privatë dhe me përputhshmërinë ndaj kërkesave të reja ligjore, ndërsa institucionet publike do ta përballojnë zbatimin e ndryshimeve brenda burimeve ekzistuese.

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me efektet që politika ose masa e propozuar mund të ketë në mënyrë indirekte mbi institucionet, bizneset dhe qytetarët.

Bizneset dhe sektori privat: Ndikimet jo të drejtpërdrejta për bizneset lidhen kryesisht me përmirësimin e klimës së përgjithshme të biznesit dhe rritjen e besimit në institucionet publike. Një kuadër më i qartë dhe më transparent rregullator mund të nxisë investimet dhe zhvillimin ekonomik.

Qytetarët: Për qytetarët, ndikimet jo të drejtpërdrejta përfshijnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit ndaj institucioneve publike. Kjo mund të ndikojë pozitivisht në perceptimin e qytetarëve mbi efikasitetin dhe integritetin e administratës publike.

Nga analiza paraprake rezulton se masa e propozuar nuk krijon kufizime të reja për konkurrencën në treg. Përkundrazi, ajo pritët të kontribujë në përmirësimin e kushteve të konkurrencës përmes:

- rritjes së transparencës në procedurat administrative dhe rregullatore;
- krijimit të një kuadri më të qartë dhe të parashikueshëm për bizneset;
- reduktimit të barrierave administrative për hyrjen në treg.

Në veçanti, përmirësimi i procedurave dhe rregullave administrative pritët të krijojë mundësi më të barabarta për të gjitha subjektet ekonomike, duke shmangur trajtimin e pabarabartë dhe duke nxitur një mjedis më konkurrues.

Në përgjithësi, ndikimi mbi konkurrencën vlerësohet **pozitiv**, pasi masat e propozuara synojnë përmirësimin e funksionimit të tregut dhe uljen e barrierave administrative.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e kryer të opsioneve të mundshme, opsioni i preferuar është Opsioni 2, i cili parashikon ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” nëpërmjet saktësimeve dhe plotësimeve të dispozitave ekzistuese.

Zgjedhja e opsionit rregullator bazohet në faktin se ky opsion mundëson trajtimin më efektiv të problematikave të identifikuara në kuadrin aktual ligjor dhe kontribuon në arritjen e objektivave të politikës publike në fushën e raportimit financiar dhe të kontabilitetit. Ndryshimi i ligjit ekzistues konsiderohet një ndërhyrje e nevojshme për të siguruar harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Opsioni rregullator – ndryshimi i ligjit nr.25/2018 – është opsioni më i përshtatshëm pasi natyra e ndryshimeve të nevojshme është plotësisht **rregullatore** dhe këto ndryshime nuk mund të adresohen me mjete jorregullatore.

Ky është opsioni i përshtatshëm për arsye se nëpërmjet këtij opsioni sigurohet:

- **Përafrim i plotë me *acquis* të BE-së.** Nisma e propozuar për ndryshimin e ligjit është e domosdoshëm për të siguruar përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së, në veçanti me kërkesat e zgjeruara të Direktivës CSRD dhe me standardet ESRS të hartuara nga EFRAG, të cilat prekin drejtpërdrejt mënyrën e raportimit jofinanciar dhe strukturën e informacionit të detyrueshëm.
- **Modernizim i kornizës kombëtare të kontabilitetit.** Ligji ekzistues i vitit 2018 nuk përfshin konceptet bashkëkohore të qeverisjes korporative, raportimit të qëndrueshmërisë, zinxhirit të vlerës, publikimit të detajuar, standardeve vullnetare dhe mekanizmave të rinj të konsolidimit. Vendosja e dispozitave të reja mbi raportimin ESG, verifikimin e raporteve të qëndrueshmërisë, raportimin e tatimit mbi të ardhurat dhe rregullat e detajuara të konsolidimit përbën një modernizim struktural, jo thjesht procedural.

- **Rritje e transparencës, krahasueshmërisë dhe besueshmërisë së informacionit.** Raportimi i qëndrueshmërisë, informacioni ESG, raportet e detyrueshme të zinxhirit të vlerës dhe raportimi i publik i tatimit mbi të ardhurat krijojnë një nivel të ri transparence për bizneset, duke bërë të mundur që investitorët, konsumatorët dhe institucionet të kenë qasje më të plotë te informacioni për performancën dhe përgjegjshmërinë e ndërmarrjeve. Kjo përmirëson qartësinë e informacionit financiar dhe jofinanciar dhe rrjedhimisht ul rrezikun e keqinformimit
- **Përmirësim i klimës së biznesit dhe tërheqje e investimeve.** Transparenca e shtuar, përputhshmëria me standardet europiane dhe rritja e cilësisë së raportimit e bëjnë Shqipërinë një destinacion më të sigurt për investitorët e huaj dhe vendas. Harmonizimi me standardet ESRS dhe me kërkesat e BE-së i jep investitorëve siguri se raportet e subjekteve shqiptare janë të krahasueshme me ato të ndërmarrjeve europiane.
- **Mbrojtja e bizneseve të vogla dhe të mesme nga ngarkesa të panevojshme.** Fakti se subjekti raportues nuk mund të kërkojë të dhëna shtesë që tejkalojnë këto standarde, ul ndjeshëm barrën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo qasje e balancuar ruan konkurrueshmërinë e tyre, shmang kosto të panevojshme.
- **Periudha të qarta tranzitore,** ku detyrimet për raportimin e qëndrueshmërisë dhe për raportimin e tatimit mbi të ardhurat bëhen të detyrueshme duke filluar nga periudhat raportuese 2028. Kjo qasje u jep ndërmarrjeve kohë të mjaftueshme për të ngritur kapacitetet e tyre të brendshme, për t'u pajisur me sistemet e duhura të teknologjisë së informacionit, për të trajnuar stafin dhe për të vendosur praktikatat e mbledhjes së të dhënave.
- Ndërhyrjet e propozuara, **nuk tejkalojnë pragun 50% të ndryshimeve në ligjin ekzistues.** Sipas parimeve të teknikës legjislative, kur ndryshimet nuk prekin më shumë se gjysmën e dispozitave të ligjit bazë, **ndërhyrja duhet të bëhet përmes ndryshimeve dhe shtesave në ligjin ekzistues,** jo përmes hartimit të një ligji krejtësisht të ri. Kjo siguron koherencë, qartësi dhe vazhdimësi në legjislacion, duke shmangur nevojën për të ristrukturuar të gjithë aktin dhe për të ndryshuar në mënyrë të panevojshme strukturën e tij themelore.
- Pjesa më e madhe e dispozitave themelore, parimeve dhe mekanizmave ekzistues ruhet, ndërsa ndryshimet fokusohen në shtesa dhe riformulime që lidhen drejtpërdrejt me përafrimin me acquis të BE-së. Dispozitat e reja janë të integruar si nene shtesë, pa cenuar strukturën themelore të ligjit. Kjo tregon se ndërhyrjet **nuk justifikojnë hartimin e një ligji të ri,** por përkundrazi konfirmojnë se opsioni i duhur është ai rregullator: ndryshimi i ligjit ekzistues.

Për më tepër, ruajtja e ligjit bazë dhe ndërhyrjet përmes shtesave e ndryshimeve siguron **vazhdimësi juridike**, shmang boshllëqet, shmang konfuzionin te subjektet e zbatimit dhe i jep kohë subjekteve të përshtaten me detyrimet e reja.

Ky projektligj nuk ka efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

<u>Kriteret</u>	<u>Pesha</u>	<u>Opsioni</u> <u>0</u>	<u>Opsioni</u> <u>1</u>	<u>Opsioni</u> <u>2</u>	<u>Opsioni</u> <u>3</u>
	<u>4</u>	<u>0 (0)</u>	<u>0 (0)</u>	<u>4 (16)</u>	<u>4 (16)</u>

Përafrimi me legjislacionin e BE-së					
Efikasiteti në raportime financiare cilësore	<u>4</u>	<u>1 (4)</u>	<u>1 (4)</u>	<u>4 (16)</u>	<u>4 (16)</u>
Krijimi i mekanizmave për sigurimin e një sistemi të unifikuar, të digjitalizuar dhe të besueshëm kontabël,	<u>4</u>	<u>0 (0)</u>	<u>1(4)</u>	<u>4(16)</u>	<u>4 (16)</u>
Efikasiteti në rritjen e transparencës së raportimit dhe publikimit të pasqyrave financiare	<u>3</u>	<u>1 (3)</u>	<u>2 (6)</u>	<u>3 (9)</u>	<u>3 (9)</u>
Kosto-efektiviteti	<u>5</u>	<u>1 (5)</u>	<u>2 (10)</u>	<u>5 (25)</u>	<u>3 (15)</u>
Pikët		<u>12</u>	<u>24</u>	<u>82</u>	<u>72</u>

Sikurse rezulton nga analiza opsioni i preferuar rezulton opsioni 2 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me krahasuar me opsionet e tjera.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Në tërësi, përmes kësaj ndërhyrjeje synohet krijimi i një sistemi më modern, transparent dhe të besueshëm të raportimit financiar dhe jo financiar, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes së ndërmarrjeve, rritjen e besimit të investitorëve, përmirësimin e klimës së biznesit dhe avancimin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Ky sistem pritet gjithashtu të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe në forcimin e stabilitetit të tregut financiar në vend.

Në procesin e zbatimit do të përfshihen edhe disa institucione dhe organizma të tjerë që kanë rol të rëndësishëm në sistemin e raportimit financiar. Një rol qendror do të luajë Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, i cili është përgjegjës për hartimin, përditësimin dhe interpretimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit, si dhe për sigurimin e përputhshmërisë së tyre me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Ky institucion do të kontribuojë në zbatimin praktik të ndryshimeve të reja përmes përditësimit të standardeve dhe udhëzimeve profesionale për subjektet raportuese.

Në mënyrë më konkrete, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit do të angazhohet në rishikimin dhe përditësimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në përputhje me ndryshimet ligjore të propozuara, si dhe në harmonizimin e tyre me zhvillimet më të fundit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe kërkesave për raportimin e qëndrueshmërisë. Gjithashtu, ky institucion do të hartojë udhëzime interpretative dhe dokumente shpjeguese për

të lehtësuar zbatimin praktik të kërkesave të reja nga njësitet ekonomike dhe profesionistët e fushës.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit do të kontribuojë gjithashtu në procesin e konsultimit publik me grupet e interesit, duke përfshirë organizatat profesionale të kontabilistëve dhe audituesve, përfaqësues të biznesit, institucionet rregullatore dhe aktorë të tjerë relevantë, me qëllim sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të përditësimit të standardeve dhe udhëzimeve përkatëse.

Për më tepër, ky institucion do të mbështesë procesin e zbatimit përmes organizimit të aktiviteteve informuese, seminareve dhe trajnimeve për profesionistët e kontabilitetit dhe subjektet raportuese, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar. Në këtë kuadër, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Financave, organizatat profesionale dhe institucionet e tjera përkatëse, për të siguruar një zbatim të koordinuar dhe efektiv të ndryshimeve ligjore.

Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit do të monitorojë zhvillimet ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke propozuar përditësime të mëtejshme të standardeve kombëtare, kur është e nevojshme, për të garantuar që sistemi i raportimit financiar në Shqipëri të mbetet i harmonizuar me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, roli i këtij institucioni do të jetë thelbësor për zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të ndryshimeve të propozuara në kuadrin ligjor.

Gjithashtu, në zbatimin e ligjit do të përfshihen edhe organizatat profesionale të kontabilistëve dhe audituesve ligjorë, të cilat do të kenë rol në trajnimin, edukimin dhe informimin e profesionistëve të fushës mbi kërkesat e reja ligjore dhe standardet e përditësuara të raportimit financiar. Këto organizata do të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit.

Në mënyrë më konkrete, organizatat profesionale do të angazhohen në hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional, duke përfshirë temat që lidhen me kërkesat e reja të raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë, si dhe me përditësimet e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit. Këto aktivitete do të synojnë forcimin e kapaciteteve profesionale të kontabilistëve dhe audituesve ligjorë, si dhe sigurimin e zbatimit të njëtrajtshëm dhe cilësor të kërkesave të reja nga subjektet raportuese.

Organizatat profesionale do të kontribuojnë gjithashtu në përgatitjen dhe publikimin e materialeve udhëzuese, dokumenteve shpjeguese dhe praktikave më të mira profesionale, të cilat do të ndihmojnë profesionistët në interpretimin dhe zbatimin korrekt të dispozitave të reja ligjore dhe standardeve të raportimit financiar. Në këtë kuadër, ato do të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe institucionet e tjera përkatëse, për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të harmonizuar në zbatimin e ligjit.

Për më tepër, organizatat profesionale do të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e konsultimit dhe dhënies së opinioneve profesionale gjatë hartimit dhe përditësimit të akteve nënligjore dhe standardeve përkatëse, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së kuadrit rregullator dhe në përshtatjen e tij me nevojat praktike të profesionistëve dhe subjekteve raportuese.

Gjithashtu, përmes aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional dhe mekanizmave të vetërregullimit, organizatat profesionale do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së

shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit, në rritjen e profesionalizmit dhe etikës profesionale, si dhe në forcimin e besimit të publikut dhe të palëve të interesuara ndaj informacionit financiar të raportuar. Në këtë mënyrë, roli i organizatave profesionale do të jetë thelbësor për zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të ndryshimeve të reja ligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Nga ana tjetër, institucione të tjera rregullatore dhe mbikëqyrëse, si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, do të kontribuojnë në zbatimin e ndryshimeve përmes funksioneve të tyre mbikëqyrëse dhe administrative, veçanërisht në lidhje me raportimin financiar, publikimin e pasqyrave financiare dhe kontrollin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore.

Në mënyrë më konkrete, këto institucione do të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të unifikuar të kërkesave të reja ligjore në sektorët që mbulojnë, përmes monitorimit të praktikave të raportimit financiar dhe mbikëqyrjes së subjekteve që janë nën juridiksionin e tyre. Në këtë kuadër, ato do të kontribuojnë në identifikimin e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të ligjit dhe në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator.

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës për institucionet financiare bankare dhe disa institucione të tjera financiare, do të monitorojë zbatimin e kërkesave të reja të raportimit financiar nga subjektet që ajo mbikëqyr, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me kuadrin ligjor dhe standardet përkatëse. Gjithashtu, ajo do të bashkëpunojë me institucionet e tjera përkatëse për të siguruar një qasje të koordinuar në zbatimin e ndryshimeve të reja ligjore.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të kontribuojë në zbatimin e ligjit për subjektet që operojnë në tregjet financiare jo-bankare, përfshirë shoqëritë e sigurimit, fondet e investimit, fondet e pensioneve dhe subjektet e tjera të mbikëqyrura prej tij. Ky institucion do të monitorojë cilësinë e raportimit financiar dhe përputhshmërinë me kërkesat e reja ligjore, si dhe do të mbështesë procesin e zbatimit përmes udhëzimeve dhe komunikimit me subjektet e mbikëqyrura.

Ndërkohë, Qendra Kombëtare e Biznesit do të ketë një rol të rëndësishëm në administrimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të depozituara nga njësitë ekonomike, duke siguruar aksesin e publikut dhe palëve të interesuara në informacionin financiar të raportuar. Gjithashtu, kjo qendër do të kontribuojë në përmirësimin e proceseve të depozitimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, në përputhje me kërkesat e reja ligjore dhe standardet e përditësuara të raportimit financiar.

Për më tepër, këto institucione do të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe organizatat profesionale për të siguruar një zbatim të koordinuar dhe efektiv të ndryshimeve ligjore, si dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe rritjen e transparencës në aktivitetin ekonomik. Në këtë mënyrë, roli i institucioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse do të jetë thelbësor për funksionimin efektiv të sistemit të raportimit financiar dhe për arritjen e objektivave të kësaj nisme ligjore.

Në tërësi, zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet përmes një bashkëpunimi institucional ndërmjet ministrisë përgjegjëse për financat, institucioneve rregullatore dhe organizatave profesionale, duke siguruar një implementim të koordinuar dhe efektiv të ndryshimeve ligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Për zbatimin efektiv të ndryshimeve të propozuara në ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ministria e Financave, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në fushën e raportimit financiar, do të ndër marrë një sërë masash institucionale dhe administrative.

Në këtë kuadër, do të vijojë përditësimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe harmonizimi i tyre me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. Një rol të rëndësishëm në këtë proces do të ketë Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, i cili do të kontribuojë në zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve dhe udhëzimeve profesionale për zbatimin e kërkesave të reja ligjore.

Gjithashtu, do të ndërmerren masa për rritjen e kapaciteteve institucionale të institucioneve përgjegjëse dhe të profesionistëve të fushës së kontabilitetit dhe auditimit, nëpërmjet programeve të trajnimit dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit për zbatimin e kërkesave të reja për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë.

Një rëndësi e veçantë do t’i kushtohet edhe bashkëpunimit me institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe me organizatat profesionale të kontabilistëve dhe audituesve ligjorë, me qëllim përmirësimin e zbatimit të standardeve dhe rritjen e cilësisë së raportimit financiar në vend.

Konkretisht, do të ndërmerren aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere për subjektet ekonomike që preken nga ndryshimet ligjore, në mënyrë që të sigurohet një zbatim gradual dhe i efektshëm i kërkesave të reja për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë.

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Zbatimi i ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” mund të përballlet me disa pengesa praktike dhe institucionale, të cilat lidhen kryesisht me kapacitetet institucionale, përshtatjen e bizneseve me kërkesat e reja dhe kostot e zbatimit të tyre.

Së pari, një nga pengesat kryesore lidhet me kapacitetet profesionale dhe teknike të aktorëve të përfshirë në raportimin financiar. Zbatimi i kërkesave të reja, veçanërisht në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë dhe raportimin jofinanciar, kërkon njohuri të specializuara dhe trajnime të mëtijshme për kontabilistët, audituesit dhe stafin financiar të shoqërive. Në këtë drejtim, institucionet përgjegjëse si Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të mbështesin procesin përmes udhëzimeve metodologjike dhe programeve të trajnimit.

Së dyti, një pengesë tjetër lidhet me kostot shtesë të përshtatjes për subjektet ekonomike, veçanërisht për njësitë e vogla dhe të mesme. Edhe pse shumica e njësive të mëdha tashmë përgatisin raporte të ngjashme për shkak të pjesëmarrjes në grupe ndërkombëtare, për disa subjekte mund të kërkohej investim në sisteme të reja raportimi, softwer kontabël dhe trajnime profesionale për stafin. Këto kosto fillestare mund të krijojnë vështirësi për disa biznese në fazën e parë të zbatimit.

Një pengesë tjetër e mundshme lidhet me koordinimin institucional ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit. Institucione të ndryshme, si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, kanë rol në monitorimin e raportimit financiar dhe publikimin e pasqyrave financiare. Mungesa e

koordinimit efektiv ndërmjet këtyre institucioneve mund të krijojë vonesa ose paqartësi në zbatimin praktik të dispozitave të reja.

Gjithashtu, mund të paraqiten sfida në përshtatjen e kuadrit teknik dhe procedural, si përditësimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit, zhvillimi i udhëzimeve të reja metodologjike dhe përshtatja e sistemeve elektronike për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare.

Megjithatë, këto pengesa konsiderohen të menaxhueshme dhe mund të adresohen përmes një periudhe të përshtatshme tranzitore, përmes trajnimeve profesionale dhe përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit. Në këtë mënyrë do të sigurohet një zbatim gradual dhe efektiv i ndryshimeve të propozuara në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për të siguruar zbatimin efektiv të ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, do të ndërmerren një sërë masash institucionale, rregullatore dhe administrative, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Së pari, do të realizohet përditësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator dhe nënligjor që lidhet me zbatimin e ligjit të kontabilitetit. Në këtë kuadër, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, do të hartojë udhëzime dhe akte nënligjore për zbatimin e dispozitave të reja që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë, raportimin financiar të njësive me interes publik dhe publikimin e informacionit financiar.

Së dyti, do të ndërmerren masa për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të aktorëve të përfshirë në raportimin financiar. Kjo do të realizohet përmes programeve të trajnimit dhe edukimit profesional për kontabilistët, audituesit ligjorë dhe profesionistët e tjerë të fushës, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për zbatimin e kërkesave të reja ligjore dhe të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Një masë tjetër e rëndësishme lidhet me përmirësimin e sistemeve të raportimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, përmes zhvillimit të mëtejshëm të sistemeve elektronike të regjistrimit dhe publikimit të tyre. Në këtë drejtim, Qendra Kombëtare e Biznesit do të vazhdojë të zhvillojë dhe përmirësojë sistemin e depozitimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, duke siguruar transparencë dhe akses më të madh për përdoruesit e informacionit financiar.

Gjithashtu, do të ndërmerren fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për bizneset dhe profesionistët e fushës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e raportimit financiar transparent dhe mbi detyrimet e reja që rrjedhin nga ndryshimet ligjore.

Në të njëjtën kohë, institucionet përgjegjëse do të forcojnë mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes për të siguruar zbatimin korrekt të ligjit nga subjektet që janë pjesë e sistemit të raportimit financiar.

- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi i projektligjit kërkon përmbushjen e një sërë kërkesash nga subjektet e përfshira në procesin e raportimit financiar.

Kontabilistët e miratuar, shoqëritë e kontabilitetit dhe audituesit ligjorë duhet të respektojnë kërkesat profesionale dhe standardet përkatëse të kontabilitetit dhe auditimit, duke garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar.

Për të siguruar përputhshmërinë me këto kërkesa, institucionet përgjegjëse do të kryejnë monitorim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, duke ndërmarrë masa administrative në rastet e mosrespektimit të detyrimeve ligjore. Në këtë mënyrë synohet të krijohet një sistem i besueshëm, transparent dhe i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*

Projektligji parashikon një sërë masash monitorimi, si vijon:

Kontrolli përmes verifikimit (auditimit)

- Në Nenin 20/4 përcaktohet shprehimisht që:
 - raportet e qëndrueshmërisë i nënshtrohen verifikimit (assurance);
 - standardet dhe procedurat përcaktohen nga ligji për auditimin ligjor.

Kjo është forma kryesore e monitorimit: audit i detyrueshëm i informacionit jo-financiar.

2. Kontrolli përmes transparencës dhe publikimit

- Raportet duhet të:
 - publikohen,
 - depozitohen në regjistrin tregtar,
 - bëhen të aksesueshme online (Neni 20/7).

Kjo krijon monitorim publik dhe institucional indirekt.

3. Përgjegjësia ligjore e organeve drejtuese

- Neni 20/6 dhe 20/4 vendos:
 - përgjegjësi kolektive të drejtuesve,
 - përgjegjësi për saktësinë dhe publikimin e raportit.

Ky është mekanizëm “disiplinues”, pra monitorim përmes përgjegjësisë ligjore.

4. Kufizime dhe kontroll i zinxhirit të informacionit

- Në Nenin 20/2 dhe 20/3:
 - rregullohet çfarë informacioni mund të kërkohet,

- kufizohet abuzimi me kërkesat ndaj zinxhirit të vlerës,
- vendosen rregulla për “vetëdeklarim” dhe mos-verifikim të detyrueshëm në disa raste.

5. Roli i standardeve të ministrisë

- Standardet e raportimit:
 - miratohen me urdhër të ministrit të financave (Neni 20/3).

Kjo krijon kontroll normativ (ex-ante) mbi mënyrën e raportimit.

Në përmbledhje:

Monitorimi i zbatimit të dispozitave për raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë realizohet kryesisht përmes një kombinimi mekanizmesh institucionalë dhe proceduralë, ku roli qendror i takon Ministrisë përgjegjëse për financat, e cila përcakton dhe miraton standardet e raportimit të qëndrueshmërisë me akt nënligjor, si dhe Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili propozon dhe mbështet zhvillimin e këtyre standardeve. Monitorimi sigurohet përmes detyrimit të njësive ekonomike për përgatitjen, publikimin dhe depozitimin e raporteve financiare dhe të qëndrueshmërisë pranë regjistrat përkatës, duke krijuar transparencë dhe akses publik në informacion. Një element kyç monitorimi është edhe verifikimi i jashtëm (auditimi dhe dhënia e sigurisë) i raporteve, i rregulluar nga legjislacioni për auditimin ligjor, i cili garanton besueshmërinë e informacionit të raportuar. Për më tepër, përgjegjësia kolektive e organeve drejtuese të njësive ekonomike për hartimin dhe publikimin e saktë të raportimeve, si dhe konsultimi me përfaqësuesit e punonjësve, përforcojnë mekanizmin e kontrollit institucional, ndërsa transparenca dhe aksesueshmëria publike shërbejnë si formë e monitorimit të tërthortë nga tregu dhe palët e interesit.

Për më tepër, institucionet shtetërore do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kërkesave të reja ligjore, duke identifikuar problematikat që mund të lindin gjatë procesit të implementimit dhe duke propozuar masa për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator. Ky proces do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të politikave publike dhe në forcimin e rolit mbikëqyrës të institucioneve përgjegjëse.

- *Identifikoni kriteret/ treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Nga përmbajtja e projektligjit, disa nga kriteret kryesore për matjen e arritjes së objektivave janë si më poshtë:

- rritja e numrit të njësive ekonomike që përgatisin dhe publikojnë raporte të qëndrueshmërisë sipas standardeve të reja dhe përputhshmëria me kërkesat ligjore (ESG: mjedis, social, qeverisje).
- niveli i harmonizimit të raportimit me Standardet e Raportimit të Qëndrueshmërisë (kuptueshmëri, krahasueshmëri, verifikueshmëri, besueshmëri).
- përqindja e njësive që raportojnë informacion të plotë për zinxhirin e vlerës dhe ulja e mungesës së të dhënave nga furnitorët/partnerët.
- rritja e raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë nga grupet ekonomike dhe përdorimi i të dhënave të verifikuara.
- numri i raporteve të verifikuara pa modifikime të theksuara dhe cilësia e opinionëve të auditimit.

- përqindja e grupeve të mëdha që publikojnë raportet e taksave sipas kërkesave dhe ndarja e informacionit sipas juridiksioneve.
- numri i degëve/njësive të kontrolluara që publikojnë raportet e qëndrueshmërisë dhe tatimit mbi të ardhurat në përputhje me ligjin.
- Reduktimi i barrës administrative: vlerësimi i kostove të raportimit për bizneset (sidomos SME-të) dhe përdorimi i standardeve vullnetare pa kërkesa shtesë të panevojshme.
- shkalla e publikimit në regjistrin tregtar dhe aksesueshmëria online e raporteve.
- niveli i përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe BE për raportimin e qëndrueshmërisë dhe transparencën fiskale.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim (ndryshimi I primit)										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	
--	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ